	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 87</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZISTA KOSTT d.d
 Nr. 215 Dt. 15/03/2016
 PRISHTINË - A

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
 Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
 Ministry of Economic Development

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit: 0113 Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.: 542
 Nr. i faqeve Broj stranica No. pages: 1 Data Datum Date: 16.03.16
 PRISHTINË/A




KOSTT

Raport Vjetor 2015


(01.01.2015-31.12.2015)

Vendimi - 160311-II/4

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e 71/16 të datës 11 mars 2016 njëzëri miratoi Raportin vjetor për vitin 2015.


	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Nebih Haziri - Zyrtar Kryesor për Financa dhe Trezor	Mustafë Hasani -Kryeshef Ekzekutiv	Drita Konxheli-Radoniqi - Kryesuese e BD
Nënshkrimi			
Data	<i>Shkurt, 2016</i>		




	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Raport Vjetor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Periudha Janar - Dhjetor 2015

1	Titulli i Dokumentit	Raport Vjetor 2015
2	Dërguesi i dokumentit	Mustafë Hasani, Kryeshef Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p>Përmbajtja</p> <p>Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT</p> <p>Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT</p> <p>1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve</p> <p>1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit</p> <p>1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja</p> <p>1.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv</p> <p>1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual</p> <p>1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it</p> <p>1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm</p> <p>1.7. Infomacionet lidhur me kapitalin dhe dividendin</p> <p>1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit</p> <p>2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv</p> <p>2.1. Arritjet kryesore</p> <p>2.2. Ngjarjet kryesore të vitit</p> <p>2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës</p> <p>2.3.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për Janar-Dhjetor 2015</p> <p>2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës – operimi i sistemit</p> <p>2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit</p> <p>2.3.4. Operimi i tregut</p> <p>2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet</p> <p>2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare</p> <p>2.4. Progresi me planin e biznesit</p> <p>2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2015</p>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

		<p>2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm</p> <p>2.7. Rreziqet</p> <p>Anekset</p> <p style="padding-left: 40px;">1. Sponzorimet dhe donacionet</p> <p style="padding-left: 40px;">2. Raportet e auditorit të brendshëm</p> <p style="padding-left: 40px;">3. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike</p> <p>3.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit</p> <p>3.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p>3.3. Kontratat/transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit 2015 nga burimet e KOSTT</p> <p>3.4. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës</p> <p>Lista e shkurtesave</p>
4	Data e Raportimit	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Hyrje

Raporti Vjetor për vitin 2015 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Sipas këtij Ligji, brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Ky Raport është punuar sipas formës së aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike ndërsa përmbajtja e tij është e bazuar në “Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike”, të pranuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, Raporti dërgohet në Njësinë për Politika dhe Monitorim të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2015 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 5 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala hyrëse e Kryesueses së Bordit të KOSTT-it

KOSTT-i si ndërmarrje publike, me qëllim të përmbushjes së misionit të vet, ka vazhduar të ofrojë shërbime kualitative dhe të besueshme të transmisionit të energjisë elektrike dhe operimit të sistemit dhe tregut të energjisë elektrike, të cilat janë dy nga objektivat dhe aktivitetet themelore të KOSTT.

Viti 2015 për KOSTT është vit i arritjes së sukseseve të jashtëzakonshme, ndër të cilat vlen të veçohet plotësimi i të gjitha kriterëve teknike për operimin e pavarur të KOSTT si bllok kontrollues, nënshkrimi i marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E, nënshkrimi i marrëveshjes për pjesëmarrjen në mekanizmin e kompensimit ndërkufitar (ITC). Gjithashtu, duhet theksuar se KOSTT me sukses dhe brenda afatit ka përfunduar një ndër projektet më të rëndësishme për sektorin e energjisë elektrike, linjën 400kV Kosovë – Shqipëri.


KOSTT, gjatë vitit 2015, ka vazhduar të ketë performancë të mirë teknike dhe financiare. Shërbimet e ofruara për konsumatorët kanë qenë të kënaqshme dhe të besueshme, e që është objektiva kryesore e KOSTT.

Njëkohësisht, gjatë vitit 2015, KOSTT është ballafaquar me sfida të mëdha sa i përket integritimeve rajonale. Për shkak të çështjeve të hapura politike, nuk ka arritur të fillojë operimin e pavarur sipas Marrëveshjes së kyçjes, sfidë kjo e cila do të përcjellë KOSTT edhe gjatë vitit të ardhshëm.

Bordi i Drejtorëve dhe të gjithë punonjësit e KOSTT janë të përkushtuar që të vazhdojnë punën e veshme dhe angazhimin maksimal për avancimin, zhvillimin e KOSTT si dhe integrimin në mekanizmat dhe organizatat rajonale.

Sinqerisht,

Drita Konxheli Radoniqi
Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Busheti</i>

Fjala e Kryshefit Ekzekutiv të KOSTT –it

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,


Gjatë vitit 2015 përkundër sfidave të shumta, KOSTT ka përmbyllur me sukses procese të rëndësishme për të ardhmen e kompanisë dhe sektorit të energjisë në përgjithësi në Kosovë. Ky vit, ka shënuar dy momente historike për kompaninë: pas 27 vitesh që kur u ndërtua linja e parë interkonektive me Shqipërinë, viti 2015 shënoi përfundimin e punimeve në linjën 400 kV që lidhë Nënstacionin Kosova B me Nënstacionin Tërana 2. Me përfundimin e linjës në fjalë, tani më Sistemi Transmetues i Kosovës do të jetë i lidhur me nivelin 400 kV me të gjitha shtetet fqinje, gjë e cila e forcon edhe më shumë pozitën e Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës në rajon si një nyje e rëndësishme e cila akomodon tranzitin dhe i kontribuon sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit rajonal energjetik.

Duke u bazuar në diversitetin e resurseve energjetike që janë shumë kompatible, me funksionalizimin e linjës së re ndërshtetërore e cila pritet të bëhet nga mesi i vitit 2016, me përfundimin e punimeve në pjesën e Shqipërisë, dobitë do të jenë të shumta për të dy sistemet.

Në anën tjetër, firmosja e kontratës tregtare për Rregullim Sekondar me Shqipërinë, mund të konsiderohet si një hap i rëndësishëm i bashkëpunimit më substancial në mes të dy kompanive homologe e cila për më tepër i mundëson KOSTT-it që të pavarësohet si operator i transmisionit në nivel të asociacionit të transmisioneve evropiane (ENTSO-E). Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në vitin 2015 për KOSTT ishte nënshkrimi i Marrëveshjes për Kycje me ENTSO-E i cili u mundësua pas verifikimeve dhe testeve të hollësishme teknike që u bënë nga ana e ENTSO-E. Kjo marrëveshje kontraktuale, i mundëson KOSTT-it të bëhet zonë/blok kontrollues i pavarur në kuadër të zonës sinkrone të Europës Kontinentale si dhe, edhe në baza legale dhe komerciale të operoj Sistemin e Transmisionit të Kosovës sinkron me Sistemin Evropian të Transmetimit të energjisë elektrike. Megjithatë, përkundër kësaj të arriture historike, për shkak të obstrukcioneve të vazhdueshme të Serbisë, Marrëveshja ende nuk ka hy në fuqi, prandaj neve na mbetet një sfidë serioze për të punuar në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2015 nga Qendra Nacionale Dispeçerike e KOSTT janë menaxhuar rrjedha më të mëdha të energjisë elektrike nëpër rrjetin e transmisionit për 3.57% në krahasim me vitin paraprak, derisa niveli i humbjeve në transmision vazhdon të mbetet më i ulëti në rajon. Këto janë vetëm disa nga indikatorët që tregojnë se viti 2015 është përmbyllur me rezultate pozitive sa i përket performancës së Sistemit të Transmisionit.

Sa i përket zhvillimit të rrjetit, KOSTT në pajtim me mandatin e saj dhe në përputhje me Planin Zhvillimor të Transmisionit vazhdon të jetë një hap përpara duke ruajtur dhe avancuar nivelin e gatishmërisë së rrjetit transmetues për të akomoduar kapacitetet e reja gjeneruese përfshirë dhe burimet e ripërtrishme të energjisë elektrike. Investimet e realizuara gjatë vitit 2015 kanë qenë mbi 36 milion Euro, ndërsa me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar si KfW, EBRD, Komisioni Evropian etj. janë kontraktuar projekte të reja në vlerë prej 34,505,733.47€.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Gjatë vitit 2015, KOSTT ka vazhduar të ruajë stabilitetin financiar, dhe të gjitha obligimet financiare ndaj palëve janë realizuar, derisa Opinioni i Auditorit të Pavarur për pasqyrat financiare vazhdon të jetë pa asnjë kualifikim.


KOSTT do të vazhdojë që në mënyrë proaktive të punoj në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike, dhe në ngritjen e kapaciteteve të transmisionit duke kontribuar kështu në krijimin e kushteve për sigurinë e furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit. Në cilësi të Kryeshefit Ekzekutiv, dua të falënderoj në veçanti punonjësit e KOSTT, të cilët me profesionalizimin e tyre, me entuziazëm dhe përkushtim të vazhdueshëm kanë bërë që KOSTT me sukses të përmbush misionin e vet. KOSTT vazhdon të insistoje në ruajtjen e standardeve më të larta të kujdesit për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e punonjësve.

Jam i vendosur që të vazhdojmë me operimin efikas dhe eficient të KOSTT-it sipas standardeve më të mira ndërkombëtare në mënyrë që të krijojmë vlerë të shtuar për aksionarin, dhe Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës.

Na mbetet dhe shumë punë për t'u bërë në vitin 2016, megjithatë, mbetemi të përkushtuar në ruajtjen dhe krijimin e vlerave të reja në sistemin elektroenergjetik dhe nga pozicioni ynë të japim kontributin në rritjen ekonomike dhe mirëqenien shoqërore të Kosovës.

Sinqerisht,

Mustafë Hasani
Kryeshef Ekzekutiv

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1. Raporti i Kryesueses së Bordit të Drejtorëve

1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarrja gjatë vitit

Deri me datën 2 shtator 2015 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka qenë në përbërjen vijuese:

1. Ramadan Paçarada, u.d. Kryesues i Bordit
2. Nazmi Mikullovc, Anëtarë i Bordit
3. Lutfi Maxhuni, Anëtarë i Bordit
4. Fatos Ukaj, Anëtarë i Bordit

Nga data 29 janar 2014 Ministri i Zhvillimit Ekonomik me vendimin nr. 01/178 ka emëruar përbërjen e re të Komisionit të Auditimit, për arsye se i njëjti nuk ka qenë i kompletuar.

Përbërja e Komisionit të Auditimit nga data 29 janar 2014 deri me datën 2 shtator 2015 ka qenë si në vijim:

1. Fatos Ukaj, Kryesues
2. Nazmi Mikullovc, Anëtarë
3. Lutfi Maxhuni, Anëtarë


Përbërja e re e Bordit të Drejtorëve të KOSTT është caktuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike me vendimin 07/47 te datës 02.09.2015, ndërsa mbledhja konstituive është mbajtur me datë 25 shtator 2015. Sipas vendimit nr. 07/47 te datës 02.09.2015 Drejtorët e Bordit janë:

1. Drita Konxheli-Radoniqi (Kryesuese),
2. Gani Jashari (anëtar),
3. Musa Misini (anëtar),
4. Anita Cucovic (anëtar),
5. Afrim Prekazi (anëtarë),
6. Nebih Zariqi (anëtar),

Ministri i Zhvillimit Ekonomik në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike me vendimin 2402 i datës 06.10.2015, emëroi Komisionin e Auditimit, në përbërjen vijuese:

1. z. Afrim Prekazi (Kryesues),
2. znj. Anita Cucovic (anëtare),
3. z. Musa Misini (anëtar).

Ndërsa mbledhja konstituive e përbërjes së re të Komisionit të Auditimit është mbajtur me 22 tetor 2015.


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 9 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Gjatë vitit 2015 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka mbajtur gjithsejtë trembëdhjete (13) mbledhje të rregullta, dhe dy (2) mbledhje të jashtëzakonshme. Bordi i Drejtorëve gjithashtu ka mbajtur edhe Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin.

Ndërsa Komisionit i Auditimit gjatë vitit 2015 ka mbajtur gjithsejtë njëmbëdhjete (11) mbledhje.

Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Raporti për tremujorin e katërt 2014 (TM4 2014)
2	Raporti vjetor për vitin 2014
3	Elaborati i regjistrimit vjetor të pasurisë për vitin 2014
4	Plani i punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2015
5	Raportet për tremujor për vitin 2015 (TM1, TM2, TM3)
6	Rishikimi i planit të biznesit dhe buxhetit për vitin 2015
7	Miratimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare dhe Letrën e menaxhmentit për vitin 2014
8	Miratim i Marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E
9	Miratimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare rregullative për vitin 2014
10	Shpallja e konkursit për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv
11	Emërimi i Ushtresit të Detyrës së pozitës së Kryeshefit Ekzekutiv
12	Miratimi i planit të biznesit dhe Buxhetit për vitin 2016
13	Emërimi i Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT

Përveç çështjeve dhe vendimeve të paraqitura më lartë, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave sipas Ligjit për ndërmarrje publike në vazhdimësi kanë shqyrtuar performancën e KOSTT, dhe kanë qenë mbështetës për menaxhmentin në arritjen e objektivave të përcaktuara në planin e biznesit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja

Përbërja dhe struktura e Komisioneve të përkohshme të Bordit gjatë vitit 2015 ka qenë si në vijim:

I. Komisioni për financa

1. Ramadan Paçarada, Kryesues
2. Nazmi Mikullovc, Anëtarë
3. Lutfi Maxhuni, Anëtarë

II. Komisioni për staf dhe shpërblime

1. Fatos Ukaj, Kryesues
2. Lutfi Maxhuni, Anëtarë
3. Ramadan Paçarada, Anëtarë

III. Komisioni për hulumtime dhe teknologji

1. Nazmi Mikullovc, Kryesues
2. Ramadan Paçarada, Anëtar

Komisioni për financa ka mbajtur një (1) mbledhje.

Komisioni për staf dhe shpërblime ka mbajtur një (1) mbledhje.

Komisioni për hulumtime dhe teknologji ka mbajtur një (1) mbledhje.

Drejtorët e Bordit në KOSTT në vazhdimësi kanë qenë në komunikim dhe bashkëveprim me menaxhmentin e KOSTT-it, që ka rezultuar me efikasitet më të madhe në marrjen e vendimeve të nevojshme.

Bordi i Drejtorëve të KOSTT në mbledhjen e 68/15 me qëllim të njoftimit më të afërt me zhvillimet lidhur me fillimin e operimit të pavarur të KOSTT si Zonë Rregulluese dhe mbështetjen e menaxhmentit në arritjen e objektivave të KOSTT, ka themeluar Komisionet e përkohshme si në vijim.

1. Komisioni për operimin e sistemit

Drita Konxheli Radoniqi (Kryesuese)

Gani Jashari


Musa Misini

2. Komisioni për operimin e tregut

Gani Jashari (Kryesues)

Nebih Zariqi

Drita Konxheli Radoniqi

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

3. Komisioni për çështje ligjore dhe rregullative

Nebih Zariqi (Kryesues)

Afrim Prekazi

Anita Cucovic

1.3. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

Gjatë vitit 2015, deri me datën 2 shtator 2015 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë në përbërje si vijon:

Ramadan Paçarada, (u.d) Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KOSTT, Kryesues i Komisionit për financa, anëtarë i komisionit për staf dhe shpërblime, anëtarë i komisionit për hulumtime dhe teknologji, me profesion: ekonomist.

Gjithsejt kompensimet 2015: € 7,218.33 + € 5,1000 performanca e vitit 2014 (Bruto)

Faton Deda, Anëtar i Bordit të Drejtorëve deri me datën 14 nëntor 2014.

Gjithsejt kompensimet 2015: € 357 0 vetëm performanca e vitit 2014 (Bruto)

Fatos Ukaj, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it; Kryesues i Komisionit të Auditimit; kryesues i Komisionit për staf dhe shpërblime; me profesion: ekonomist - Profesor universitar.

Gjithsejt kompensimet 2015: € 7,781.67 + €4,500 performanca e vitit 2014 (Bruto)

Lutfi Maxhuni, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, anëtarë i Komisionit të Auditimit, anëtarë i Komisionit për Financa, anëtarë i Komisionit për staf dhe shpërblime; me profesion: ekonomist

Gjithsejt kompensimet 2015: € 7,470 + € 4500 performanca e vitit 2014 (Bruto)


Nazmi Mikullovci, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT, anëtarë i Komisionit të Auditimit, kryesues i Komisionit për hulumtime dhe teknologji; anëtarë i Komisionit për financa; me profesion: inxhinier

Gjithsejt kompensimet 2015: €7,500 +4,500 performanca e vitit 2014 (Bruto)

Nga data 2 shtator 2015 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka qenë në përbërjen vijuese:

Drita Konxheli-Radoniqi, Kryesuese e Bordit të Drejtorëve, anëtare e Komisionit për operimin e tregut, Kryesuese e Komisionit për operimin e sistemit, me profesion ekonomiste Profesoreshë e lëndëve ekonomike në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës.

Gjithsejt kompensimet 2015: €3,371.67 .

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Gani Jashari, Drejtor i Bordit, Kryesues i Komisionit për operimin e tregut, anëtarë i Komisionit për operimin e sistemit, me profesion fizikant, Profesor i lëndëve fizike në Fakultetin e Fizikës në Universitetin e Prishtinës.

Gjithsejt kompensimet 2015: € 2,975.00.

Musa Misini, Drejtor i Bordit, Anëtarë i Komisionit të Auditimit, anëtarë i Komisionit për Operimin e Sistemit, me profesion inxhinier i elektros.

Gjithsejt kompensimet 2015: € 3,395.96.

Anita Cucovic, Drejtore e Bordit, anëtare e Komisionit të Auditimit, anëtare e Komisionit për Çështje Ligjore dhe Rregullative, me profesion ekonomiste, Profesoreshë e lëndëve ekonomike në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Pejës.


Gjithsejt kompensimet 2015: € 3,395.96.

Afrim Prekazi, Drejtor i Bordit, Kryesues i Komisionit të Auditimit, anëtarë i Komisionit për çështje ligjore dhe rregullative, me profesion jurist.

Gjithsejt kompensimet 2015: €3,536.30.

Nebih Zariqi, Drejtor i Bordit, Kryesues i Komisionit për Çështje Ligjore dhe Rregullative, anëtarë i Komisionit për operimin e tregut, me profesion inxhinier i elektros.

Gjithsejt kompensimet 2015: € 2,975.00.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual

Gjatë vitit 2015 KOSTT ka vazhduar performancën pozitive të afarizmit e cila është karakterizuar me zhvillime të shumta.

Janë bërë avancime në ngritjen e funksioneve operative në monitorim dhe kontroll, veçmas në operimin e sistemit në kohën reale. Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS, i Telekomit dhe Matjeve komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avancuara për operim të rrjetit transmetues në nivel të sigurisë së lartë, në baza planifikuese dhe në kohë reale, këmbimin e të dhënave midis objekteve elektro-energetike, TSO-ve fqinje dhe Qendrës Koordinative.

Pjesa e pa përfshirë në këto mundësi është pjesa veriore e Kosovës, ku për shkaqe të njohura ende nuk është mundësuar përfshirja në këtë paket e NS Vallaq dhe HC Ujmani. Përmes projektit në implementim e sipër “Përfshirja e të gjitha objekteve energetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS” do të përfshihen disa nënstacione të reja të ndërtuara dhe transformatorët e shtuar në ato ekzistuese, të implementuara pas përfundimit të projektit të SCADA\EMS & Telekom.

Megjithatë, mbetet që për kalimin e “aseteve të NS 110/x kV së bashku me shërbimet përcjellëse nga KEK në KOSTT”, duhet të zgjerohet niveli i kontrollit dhe monitorimit deri në kufirin e ri. Kjo do të funksionalizohet në vazhdimësi dhe po ashtu, do të përfshihen edhe ndryshimet e tjera në rrjetin transmetues për shkak të zhvillimeve të rrjetit.


Gjatë vitit 2015 infrastruktura e SCADA\EMS dhe telekomit është avancuar duke krijuar mundësimin e shkëmbimit të observimit të rrjeteve transmetuese fqinje në kohë reale.

Infrastruktura e matjeve komerciale ka përmirësuar në masë të konsiderueshme leximin e të dhënave kumulative të energjisë elektrike në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues përmes përdorimit të Fibrave Optik në pronësi të KOSTT-it, po ashtu edhe nga distanca.

KOSTT ka vazhduar me aktivitetet e mirëmbajtjes, bazuar në planin e mirëmbajtjes dhe aktivitetet tjera të domosdoshme për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm operativ dhe sigurisë së sistemit elektroenergetik. Planin vjetor të mirëmbajtjes së linjave është realizuar 97%, ndërsa i nënstacioneve 89%.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitetet tjera jashtë atyre të planifikuara, që kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operatorit të transmisionit.

Mirëmbajtja e duhur dhe me kohë e pajisjeve elektroenergetike krahas rritjes dhe zhvillimit të infrastrukturës me teknologjinë e avancuar moderne, kanë krijuar një siguri të funksionimit të sistemit, si dhe janë krijuar kushtet për kujdesin më të madh ndaj ambientit që po ashtu është një nga prioritetet e KOSTT.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Me qëllim të mirëmbajtjes sa më efektive, është reviduar Rregullorja e Mirëmbajtjes, duke iu përshtatur teknologjisë së instaluar dhe mënyrës së qasjes së stabilimenteve, në mënyrë që të kemi më të qartë një aktivitetet në realizmin e detyrave të punës.

Edhe këtë vit, performanca financiare e KOSTT-it, është mjaft e mirë, dhe më detalisht është paraqitur në Pikën 2.3.5. të këtij Raporti.

KOSTT ka arritur caqet e parashtruara në objektivat e Planit të Biznesit për vitin 2015 dhe IKP-të e performancës operative dhe financiare janë pozitive. Këta indikatorë kyç të performancës janë vlerësuar rregullisht nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT, dhe kanë qenë pjesë e Raporteve të rregullta tremujore, të cilat janë dorëzuar në Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike.

1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it

Gjatë kryerjes së veprimtarive të saj, KOSTT ballafaqohet edhe me risqet, të cilat në mënyrë direkte i afektojnë funksionimin.


Në mesin e ngjarjeve që kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT, vlen të përmendet Marrëveshja e firmosur për energji në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila ka qartësuar që KOSTT do të ketë përgjegjësitë për operim të pavarur e që duhej filluar përafërsisht nga mesi i vitit 2015. Kjo çështje më detalisht është shpjeguar në pikën 2.1. të këtij Raporti.

KOSTT është duke aplikuar në Asociacionet ndërkombëtare të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit (ENTSO-E), me të cilët operojmë në mënyrë sinkrone, gjë e cila na mundëson ndër të tjera edhe pjesëmarrjen në mekanizmat e përbashkëta që valorizojnë çdo transaksion ndërkufitar. Valorizimi i aranzhmaneve ndërkufitare mund të sjellë të hyra në dobi të KOSTT-it dhe konsumatorëve të Kosovës.

1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit gjatë vitit 2016,do të jenë:

- Implementimi i marrëveshje multilaterale të nënshkruar nga KOSTT për kompensimin ndër TSO
- Implementimi i MoU mes TSO-ve regjionale për procedimin e krijimit të RSCI në përbërje të KOSTT (Kosovë), IPTO (Greqi), MEPSO (Maqedoni), TEIAS (Turqi), ESO (Bullgari), OST (Shqipëri) dhe Transelectrica (Rumani) si observer ;
- Fillimi i operimit të KOSTT si zonë rregulluese/bllok rregullues më vete në përputhje me rregullat e ENTSO-E;
- Implementimi i Marrëveshjes për Rregullim Sekondar me OST dhe KOSTT


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 15 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- Implementimi i marrëveshjeve Ndër- OST me OST-të fqinje;
- Implementimi i Mekanizmit Balancues si kërkesë në Dizajnin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë dhe Rregullave të Tregut;
- Investimet në platformat softuerike, rifreskimi i atyre ekzistuese, trajnimi dhe edukimi i stafit për përdorimin e tyre. Platformat softuerike si SCADA/EMS, SME (Sistemin për Menaxhimin e Energjisë), Kontrolli Frekuencë Fuqi-LFC, analiza e sigurisë së operimit një ditë para i njohur si DACF- (Day Ahead Congestion Forecast), Softuer për mbikëqyrje dhe kontroll në kohën reale, pajisjeve të TL të tipit T 5000, E-TERRA Habitat, do të mundësojnë dhe lehtësojnë kryerjen e aktiviteteve të të gjitha palëve pjesëmarrëse në tregun e energjisë, për të siguruar operim më eficient të sistemit të energjisë elektrike;
- Vazhdimi i investimeve në rrjetin e transmisionit për të arritur standarde të larta të shërbimeve ndaj klientëve dhe ngritja e efikasitetit të afarizmit financiar;
- Zgjerimi dhe eksplorimi maksimal i infrastrukturës për monitorim dhe kontroll të SEE, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese që më saktësisht konsiston në:
 1. Ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rrjetit transmetues nga Qendra Nationale Dispečerike Kryesore dhe Emergjente;
 2. Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS dhe i pajisjeve e fushave të instaluar me projekte të ndryshme në RTU në NS 110 kV;
 3. Krijimi i kushteve teknike për monitorim të ndërsjellë me OST-të fqinje në kohën reale dhe shkëmbimi i informacioneve me Qendrën Koordinative Swissgrid me seli në Zvicër.
 4. Ndërlidhja e domenit kostt_ost.com SME (Sistemin për Menaxhimin e Energjisë), kostt.com. AMR dhe zgjerimi i infrastrukturës së tij në nënstacione për nevojat e mbikëqyrjes së pajisjeve digjitale (mbrojtjet rele, IED, BCU dhe SCS) për nevojat e Operatorit të sistemit dhe Transmisionit.

Në aspektin e operimit, do të implementohet edhe projekti i Kontrollit Frekuencë-Fuqi në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë, i cili në mënyrë kuptimplote mund ta ndryshojë regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në tri variante, por që fillimisht do të aplikohet versioni i parë:

1. Operimi si dy Blloqe Rregulluese të veçanta me shkëmbim të shërbimeve ndihmëse,
2. Operimi me dy zona të ndara por në një Bllok rregullues me Shqipërinë,
3. Operimi në një zonë të përbashkët në faza të mëvonshme.

Edhe gjatë vitit 2016 KOSTT do të vazhdojë aktivitetet që lidhen me liberalizimin e Tregut të Energjisë elektrike në Kosovë. Aktivitetet e zhvilluara ishin në përputhje me

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 16 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Busheti</i>	

objektivat dhe kërkesat e qeverisë rreth liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, kërkesat që dalin nga legjislacioni primar i sektorit të energjisë; kërkesat që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore dhe Direktivat e Komisionit Evropian.

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë pritet që gjatë vitit 2016 të operojë si zonë e pavarur tregtare dhe Operatori i Tregut do ta operojë tregun e energjisë elektrike në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar si një zonë tregtare në vetë.

Në aspektin e zhvillimit të tregut, do vazhdohet puna rreth projektit për krijimin e një tregu të përbashkët Kosovë-Shqipëri.


Duke pas parasysh karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri dhe objektivat e qeverive për furnizim të sigurtë me energji elektrike KOSTT, ZRrE, ERE dhe OST kanë diskutuar dhe analizuar idenë e bashkimit të dy tregjeve në një treg të përbashkët (një zonë tregtare). Tregu i përbashkët do të jepte sinjale të dukshme për investime në kapacitete gjeneruese të reja dhe llojin tyre, për investime në rrjetin transmetues dhe të shpërndarjes, si dhe nga tregu i përbashkët do të përfitonin konsumatorët nga të dy vendet .

Tregu i përbashkët Kosovë- Shqipëri, gjithashtu do të mundësonte hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe do të krijonte kushte për një treg konkurrues.

Themelimi i një tregu të përbashkët për të gjitha afatet kohore është në harmoni me objektivat e BE-së dhe Komunitetit të Energjisë dhe kjo mund të konsiderohet si hap drejt integritimit në tregun rajonal të EJJ dhe Tregun pan Evropian të energjisë elektrike.

KOSTT-i do të vazhdojë të punojë me të gjitha kapacitetet e veta që si Operator i Tregut dhe i Sistemit, të sigurojë që të jetë plotësisht i integruar në të gjitha komponentët e tregut rajonal, të cilat aktualisht janë duke u zhvilluar. Në veçanti KOSTT-i do të:

- Përcjellë zhvillimet në rajon dhe inicijativës WB6 (i njohur si procesi i Berlinit) rreth themelimit të tregut rajonal të energjisë elektrike, tregut rajonal balancues të energjisë elektrike;
- Përmbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë;
- Jetë pjesëmarrës aktiv në të gjitha organizatat relevante rajonale dhe evropiane që kanë të bëjnë me operimin e sistemit dhe tregut;
- Bashkëpunojë me Projekt Grupin për KOSTT (PG TSO KOSTT) të themeluar nga ENTSO-E që do të monitorojë përmbushjen e standardeve të ENTSO- E nga ana e KOSTT;
- Vendosë marrëdhënie të qëndrueshme me OST-të e Evropës Kontinentale;
- Zhvillojë aftësitë e nevojshme për operimin e sistemit dhe tregut në nivel rajonal; dhe
- Kontribuojë në punën e SEE CAO (Coordinated Auction Office) dhe të angazhohet që kapacitetet interkonektive të KOSTT të alokohen nga SEE CAO, ku KOSTT është një nga themeluesit dhe aksionarët.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Edhe më tutje, prioritet i KOSTT mbetet që të avancojë sistemin e mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta, të cilat kanë filluar të zhvillohen në sistemet e avancuara, duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve , në mënyrë që të kursehet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

Plani i mirëmbajtjes për vitin 2016 del nga plani pesë vjeçar i mirëmbajtjes dhe revidohet sipas nevojës për aktivitete preventive të identifikuar si rezultat i remonteve apo kontrollimeve gjatë vitit paraprak.

1.7. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendin

Kapitali themeltar i KOSTT-it në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 (*njëzetepesëmijë*) Euro dhe është i ndarë në 25.000 aksione me vlerë nominale 1 Euro secili. Kapitali i Shoqërisë është deklaruar dhe paguar tërësisht në momentin e themelimit të KOSTT-it .

Aksionari i vetëm i KOSTT-it është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital është dhënë në pikën 2.3.5. të këtij Raporti.

1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit

Investimet kapitale të realizuar gjatë vitit 2015 në KOSTT janë realizuar bazuar në Planin Zhvillimor dhe Planin Investiv, aprovuar nga ZRrE.


Viti 2015 ka qenë vit i realizimit të projekteve, të cilat kanë filluar vitet e mëherëshme, pra projekteve në vazhdimësi, përgaditja e Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike për projektet e reja, startimi me implementim të projekteve të reja dhe ajo që karakterizohet si rezultat më i madh i vitit është kontraktimi dhe fillimi i projekteve “Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit – Programi IV dhe V”, që janë bashkëfinansim KfW/KOSTT dhe KE (IPA programi).

Rezultat tjetër është përgaditja e specifikimeve teknike dhe tender dosjes për projektet “Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës”, të bashkë financuara nga BERZH dhe KOSTT. Specifikimi Teknik dhe Tender dosja është përgaditur në bashkëpunim me kompaninë konsulente MVV Decon/Consulectra dhe pritet që viti 2016 të jetë vit i fillimit të implementimit të këtyre projekteve.

Departamenti për Menaxhim të Projekteve & Inxhinieri realizimin e obligimeve rreth investimeve të rëndësishme në vitin 2015 e ka kategorizuar në tri grupe:

I. Përgatitja e Specifikimeve Teknike për Projektet:

1. Përgatitja e specifikimeve teknike dhe tender dosjes për “Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës” të bashkë financuara nga BERZH (kredi) dhe KOSTT. Specifikim Teknik dhe Tender dosja është përgaditur në bashkëpunim

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 18 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

me kompaninë konsulentë “MVV GmbH Decon” dhe në tremujorin e katërt të 2015 është tenderuar, pritet që viti 2016 të jetë vit i fillimit të implementimit të këtyre projekteve . Projekti është ndarë në tre LOT-a:

- **LOT 1: GIS Nënstacionet**
- NS Prishtina 6 dhe 110 kV HIS në NS Prishtina 4,
- NS Fushe Kosova;
- NS Mitrovica 2;
- NS 220/10(20) kV - Drenasi 2 dhe
- Revitalizimi i pajisjeve TL (HIS) në NS Theranda

- **LOT 2 ;** Transformatorët e fuqisë
40MVA 2x40 MVA(në NS Prishtina 6, 2x40 MVA në NS Fushe Kosova, 2x40 MVA në NS Mitrovica 2 dhe 2x40 MVA në NS Drenasi 2


- **LOT 3 : Linjat transmetuese :**
Linja e dyfishtë kabllorike NS Prishtina 6 – NS Prishtina 4;
Linja e dyfishtë kabllorike 110 kV NS Fushe Kosova;
Linja e dyfishtë 220 kV Drenasi 2;
Linja e dyfishtë kabllorike 110 kV Mitrovica2 dhe
Linja e re e njëfishtë 110 kV NS Rahoveci - NS Theranda.

2 Shërbimet konsulente për mbështetjen e përgatitjes së propozimit teknik për “Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës”;

3 Revitalizimi i NS 110/35kV Gjilani 1 dhe NS Ferizaji 1 ana 35kV

II. Menaxhimi i projekteve, projektet që kanë filluar me implementim në vitet e mëherëshme (në vazhdimësi) dhe projektet, që kanë filluar me implementim në vitin 2015:

1. Shërbimet konsulentë dhe Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - Shq - LOT 1; dhe Fusha e TL dhe LFC - LOT 2;
2. Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2 dhe Prizreni 3;
3. Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1-Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i Pajisjeve të TL në NS Gjakova 1;
4. Revitalizimi i nënstacioneve NS 110kV , ana 35kV në NS Gjakova 1;
5. Instalimi i TR 2 ne NS 110/10(20) - Skenderaj dhe instalimi i TR në NS Burim;
6. Instalimi i transformatorit të tretë në NS 110/10(20) kV Prishtina 2;
7. Instalimi i TR2 në NS 110/10kV Berivojcë dhe Viti
8. Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS KOS A ;
9. Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Prizreni 2;


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

10. Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike;
11. Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEK/OSSH;
12. Instalimi i TR 3 dhe pajisjeve të tensionit të lartë në NS Deçani :
 - *Bazuar në Marrëveshjen për Kycje KOSTT / KelKos për kycjen e Gjeneratorëve me ujë në rrjetin e Transmisionit; Investues KelKOS . Pas kalimit të afatit garantues asete e TL kalojnë në5 pronësi të transmisionit .*
13. Shërbimet Konsulente për përgatitje të tender dosjes / projekteve shtesë dhe menaxhimin e projekteve (Project preparation consultant)
14. "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit faza IV &V" kontratë kjo që është e nënshkruar në Q1 2015 dhe është e ndarë në 4 LOT
 - LOT 1: Nënstacionet [110/10(20) kV -**
 - LOT 2 - Transformatorët**
 - LOT 3 - Linjat transmetuese**
 - LOT 4 - Rehabilitimi i 19 nënstacioneve**
15. Shërbime të Konsulencës për përgatitjen e tender dosjes për “Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës” të financuara nga BERZH (EBRD).

III. Menaxhimi i projekteve, të cilat janë implementuar ose janë në afat garantues:

- Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-1:SCADA/EMS;
- Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-2: Telekom;
- Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kos A;
- Furnizimi dhe Instalimi i Kabllit mbrojtës optik ne linjën interkonektive Kosove- Mali i Zi;
- Instalimi i Kabllit mbrojtës optik OPGW ne linjën 220kV NS Podujeve dhe NS Krushevc.

Viti 2015 karakterizohet edhe me takime të shumta me KEDS rreth arritjes së marrëveshjeve për financim në projektet e përkrahjes së ngarkesës, përgatitja e Ofertave për Kycje, Marrëveshjeve të Kycjes, që pritet të finalizohen në fillim të vitit 2016 .

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 20 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

2.1. Arritjet kryesore

Në mesin e detyrave të KOSTT dhe në përputhje me objektivat e saj strategjike, një nga detyrat kryesore mbetet edhe më tutje ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit. Sa i përket përmbushjes së kësaj detyre, KOSTT ka vazhduar trendin e performimit pozitiv, edhe gjatë vitit 2015.

KOSTT ka dëshmuar edhe një herë se është një organizatë e qëndrueshme dhe efektive, duke zhvilluar një mori aktivitete që nga themelimi e deri më sot.


KOSTT ka zhvilluar infrastrukturën e operimit të sistemit dhe tregut, janë zhvilluar dhe shumë nga kodet e domosdoshme teknike dhe rregullat e tregut dhe do të vazhdojnë të zhvillohen edhe në të ardhmen. Megjithatë, tani është me rëndësi për KOSTT-in që të përgatitet për sfidat e reja me të cilat do të përballet në të ardhmen. Një vend të rëndësishëm në këtë drejtim zënë zhvillimet e tregut në Kosovë dhe rajon dhe një ndër objektivat e saj strategjike është edhe integrimi rajonal dhe arritja sa më e shpejtë e operimit si Zonë Rregulluese dhe anëtarësimit në ENTSO-E.

Gjatë vitit 2015 është implementuar me sukses linja 400kV Kosovë – Shipëri, pjesa në territorin e Kosovës, dhe është testuar me sukses LFC KOSTT-OST.

Grupi punues i njohur CME-Group për vlerësimin e përputhshmërisë së operimit në përputhje me OH (Operational Handbook) i themeluar nga ENTSO-E, ka vlerësuar gjendjen aktuale të operimit të sistemit në Kosovë dhe ka verifikuar nivelin e jo përputhshmërisë me standardet e operimit sipas OH. KOSTT ka plotësuar pyetësin (Questionare about compliance monitoring assesment) dhe grupi punues CME për vlerësim të pyetësit, ka dhënë rekomandim ENSTO-E që KOSTT t'i ofrohet Marrëveshja e Kyçjes. Në shkurt 2015 RGCE ka miratuar një Kalendar (Road Map) të aktiviteteve që duhet të ndërmerren në mënyrë që KOSTT të nënshkruante marrëveshjen e kyçjes dhe të fillonte operimin si zonë rregulluese/bllok rregullues, duke filluar nga data 01.06.2015.

Në udhërrëfyes fillimisht janë definuar kushtet themelore, afatet kohore që duhet të përmbushen për nënshkrimin e marrëveshjes së kyçjes dhe fillimin e operimit si zonë rregulluese. Kushtet kanë qenë si në vijim:

- Testimi i platformave softuerike dhe procesit të nominimit ndërkuftar (scheduling) me TSO-të rajonale dhe Swissgird

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- Testimi i platformave softuerike dhe procesit të accountingut (të harmonizimit të matjeve në linjat interkonektive) me TSO-të fqinje dhe Swissgrid
- Testimi i modelit të Kosovës për qëllim të vlerësimit të sigurisë së operimit në ditën D. Ky test njihet DACF (Day ahead congestion forecast-Analiza e sigurisë së sistemit një ditë para)


Për këtë qëllim, respektivisht përgatitjen e marrëveshjes së kyçjes, monitorimin e implementimit të marrëveshjes së kyçjes nga KOSTT, plotësimin e kriterëve teknike të vendosura në marrëveshje, ENTSO-E ka formuar grupin punues i njohur si PG-KOSTT KOSTT, Swissgrid dhe TSO fqinje kanë bërë testet e kërkuara . Të gjitha testet kanë kaluar me sukses. Në lidhje me rezultatet e testimit PG-KOSTT ka raportuar te ENTSO-E dhe RGCE(Regional group continental Europe).

Me datën 01.10.2015 është nënshkruar Marrëveshja për kyçje në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, e përfaqësuar nga 30 OST të Grupit Rajonal të Evropës Kontinentale.

Gjatë vitit 2015 është realizuar përfaqësim i barabartë i KOSTT-it në Grupin Punues Rajonal të Mirëmbajtjes së kapaciteteve Interkonektive dhe kapaciteteve me ndikim të drejtpërdrejt në transmetim për Rajonin e Evropës Jug-Lindore, në kuadër të ENTSO-E. Ky Grup Punues, ashtu siç e parasheh Doracakun e Operimit të ENTSO-E, Politika 4 (Planifikimi i Koordinuar Operativ), pos takimeve vjetore të organizuara nga Operatorët e Sistemeve Rajonale në principin e rotacionit, mbanë edhe Telekonferencën Javore ku raportohet për punën e Sistemit për javën e shkuar dhe planin për javën e ardhshme. Ky GP për Rajonin e EJM ka 12 anëtarë.

Përfaqësuesit e KOSTT-it kanë marr pjesë në punimet e këtij Grupi Punues për të parën herë në konferencën vjetore të mbajtur në Tiranë, nën organizimin e OST(Shqipëri) në nëntor të vitit 2013, si anëtarë vëzhgues. Ndërsa, që nga konferenca e organizuar në Stamboll, në nëntor 2014, KOSTT merr pjesë në këtë GP si anëtar i barabartë. Në nëntorin e 2015, nën patronatin e CGES (TSO e Malit të Zi) kjo konferencë është mbajtur në Podgoricë. Në konferencën në Podgoricë është harmonizuar Plani vjetor i ndërprerjeve të kapaciteteve Interkonektive dhe atyre të brendshme me ndikim në Intekonekcion për vitin 2016.

Po ashtu, është punuar në zhvillimin e strategjisë për hyrje në tregun e telekomunikimeve, duke ofruar tepricën e kapaciteteve fibër optike. Si rezultat i kësaj pune u përpilua Plani i Biznesit për Operimin e shërbimeve të infrastrukturës në tregun e telekomunikimeve, e cila ishte edhe parakusht për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për aplikim për autorizim/licencë. Tani, kjo është licenca e tretë e KOSTT-it, së bashku me licencën për Operator të Sistemit të Transmisionit dhe licencën për Operator të Tregut të energjisë elektrike, që kanë të bëjnë me biznesin themelorë të KOSTT-it. Dy licencat e para janë marr pas themelimit të KOSTT-it si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Implementimi i suksesshëm i mirëmbajtjes dhe projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT, në radhë të parë, në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimin e sistemit dhe mirëmbajtjen preventive, gjë që do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Gjatë këtij viti është realizuar 97% e planit vjetor të mirëmbajtjes së linjave, 89% e mirëmbajtjes së nënsatcioneve, si dhe janë zhvilluar aktivitetet tjera të domosdoshme për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm operativ dhe të sigurisë së sistemit elektroenergetik.

Mirëmbajtja e duhur dhe me kohë e pajisjeve elektroenergetike krahas rritjes dhe zhvillimit të infrastrukturës me teknologjinë e avancuar moderne, kanë krijuar një siguri të funksionimit të sistemit si dhe janë krijuar kushtet për kujdesin më të madhe ndaj ambientit, që po ashtu është një nga prioritetet e KOSTT.

Me qëllim të mirëmbajtjes sa më efektive, është reviduar Rregullorja e Mirëmbajtjes, duke iu përshtatur teknologjisë së instaluar dhe mënyrës së qasjes së stabilimenteve, ashtu që të kemi më të qartë një aktivitetet në realizmin e detyrave të punës. Përmes kësaj synohet që oraret dhe aktivitetet në pajisje, të jenë sa më racionale duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve. Në këtë mënyrë do të kursehet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.


Në përputhje me njërin nga objektivat e saj strategjike, KOSTT ka kontribuar në iniciativën për themelimin e tregut të përbashkët Kosovë – Shqipëri.

Përkushtimi i KOSTT-it, për arritjen e objektivit të kompanisë siç është përgjegjësia në aspektin e sigurisë dhe mjedisit, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015, duke përmbyllur vitin 2015 pa asnjë aksident apo situatë emergjente shëndetësore apo mjedisore.

Opinionin e auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2014 është pa asnjë kualifikim, dhe dëshmon sërish punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve. Po ashtu, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.

Janë aprovuar shumë dokumente të rëndësishme, politika dhe procedura në harmoni me dispozitat e Ligjit të Punës.

Të arriturat e KOSTT, respektivisht, progresi që KOSTT ka bërë gjatë vitit 2015, janë paraqitur më detalisht në pikën 2.4 të këtij Raporti, i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit për vitin 2015.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.2. Ngjarjet kryesore të vitit

-Ministrja për Dialog znj.Tahiri vizitoi KOSTT-in

Në muajin shkurt 2015, Ministrja për Dialog e Republikës së Kosovës ka zhvilluar një vizitë në KOSTT ku u njoftua nga afër me punën intensive që po zhvillohet në KOSTT për implementimin e Marrëveshjes së Operimit, e cila ka dalë nga Marrëveshja për Energji e firmosur në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Në anën e saj, Ministrja Tahiri ka vlerësuar kontributin e KOSTT në dialogun me Serbinë si dhe foli për sukseset që janë arritur në dialogun me Serbinë përmes së cilit janë njohur kufijtë elektrik që njëkohësisht paraqesin edhe kufijtë shtetëror të Kosovës.

-Ministrat Stavileci dhe Gjikhuri vlerësojnë progresin e punimeve në linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri


Në muajin mars 2015, Ministri për Zhvillim Ekonomik të Kosovës z.Blerand Stavileci dhe Ministri i Energjetikës dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë z.Damjan Gjikhuri zhvilluan një vizitë në Nënstacionin 400/220 kV Kosova B. Qëllimi i vizitës ishte njoftimi me progresin e punimeve në linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri si dhe njoftimi me rëndësinë e Nënstacionit Kosova B i cili paraqet nyje të rëndësishme në Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës, me që aty lidhen të gjitha linjat interkonektive me shtetet fqinje si dhe linja ndërlidhëse me gjeneratorët e Termocentralit Kosova B.

Nënstacioni 400/220 kV Kosova B gjithashtu paraqet pikënisjen e linjës 400 kV me Shqipërinë që lidhë këtë nënstation me Nënstacionin Tirana 2

-Nënshkruhen kontratat për zhvillimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë- Programi IV dhe V i Sektorit”

Me 19 Mars 2015, u nënshkruan kontratat për implementimin e disa projekteve për zhvillimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë- “Programi IV dhe V i Sektorit”.

Implementimi i projekteve në fjalë do të mundësohet përmes kredisë komerciale afatgjate që KOSTT sh.a e ka siguruar nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) me kushte kredituese të buta në vlerë prej € 23,5 milion nga e cila € 15,5 milion me periudhë kthyesë prej 15 viteve dhe €8 milion me periudhë kthyesë prej 40 viteve, si dhe financimin shtesë në formë granti nga Komisioni Evropian në vlerë prej € 7.3 milion përmes programit IPA. Projekti “Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit, Programi IV dhe V i Sektorit”, përbëhet nga tri LOT-e. LOT 1: Nënstacionet - i cili do të implementohet nga kompania austriake SIEMENS, Lot 2: Transformatorët – i cili do të implementohet nga kompania kroate Konçar Power Transformers, Lot 3: Linjat e Transmisionit – i cili do të implementohet nga kompania kroate Dalekovod (Zagreb).

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buscheti</i>

-Vihet gur themeli me rastin e nisjes së implementimit të projekteve në kuadër të “Programit IV dhe V” për zhvillimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë

Me 17 prill 2015, në një ceremoni solemne në Nënstacionin 400/110 kV Ferizaj 2, është vënë gur themeli me rastin e nisjes së implementimit të projekteve në kuadër të “Programit IV dhe V” për zhvillimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Kredi me KfW është bërë me datë 23 Shtator 2013, ndërsa me 19 Mars 2015 janë nënshkruar kontratat për implementim të projekteve.

Nënstacioni 400/110 kV Ferizaj 2, është një nga nënstationet më të rëndësishme të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës, në të cilin lidhet linja interkonektive 400 kV Kosovë-Maqedoni. Nënstacioni Ferizaj 2 është ndërtuar në vitin 2011 me bashkëfinancim nga Qeveria e Kosovës dhe fondet e Bashkimit Evropian.

- Pjesëmarrja në Expoforumin "Mënyrat e reja të financimit të projekteve strategjike Kosovë - Shqipëri"

Nën organizimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Diasporës së Kosovës, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Energjetikës dhe Industrisë së Shqipërisë, në Prishtinë është mbajtur Expoforumi "Mënyrat e reja të financimit të projekteve strategjike Kosovë - Shqipëri". KOSTT është përfaqësuar nga zyrtarë të lartë me prezantim dhe gjithashtu KOSTT është prezantuar me stendën ku janë promovuar publikimet, puna dhe projektet e kompanisë.

- Fillon procesi përgatitor për themelimin e KOSTT si zonë/bllok kontrollues i pavarur në kuadër të Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale


Përkundër vështirësive të vazhdueshme të paraqitura nga ana e Operatorit të Transmisionit të Serbisë (EMS) në procesin e themelimit të KOSTT si zonë/bllok kontrollues i pavarur në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale, gjatë muajve Gusht dhe Shtator, KOSTT i është nënshtruar monitorimit të vlerësimit të përmbushjes së standardeve teknike të operimit dhe balancimit të Sistemit Elektroenergjetik, nga ana e ENTSO-E dhe Swiss Grid. Nën koordinimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik është themeluar grupi koordinues nga përfaqësuesit e KOSTT, ZRRE, KEK dhe KEDS për të marrë masat për zvoglimin e devijimeve të sistemit me qëllim të mbështetjes së KOSTT në procesin e njohjes si zonë/bllok kontrollues i pavarur në kuadër të Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale.

-Qeveria e Republikës së Kosovës emëron Bordin e Drejtorëve të KOSTT sh.a

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 2 shtator 2015 ka emëruar Bordin e Drejtorëve të KOSTT sh.a në përbërje të: znj.Drita Konxheli-Kryesuese, z.Afrim Prekazi, z.Musa Misini, znj.Anita Cucoviq, z.Nebih Zariqi dhe z.Gani Jashari.

-Realizohet vizitë inspektuese punimeve në linjën ndërshtetërore Kosovë-Shqipëri

Në shtator 2015, delegacioni i përbashkët i zyrtarëve të lartë të Qeverisë së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë, kanë realizuar një vizitë inspektuese punimeve për

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

ndërtimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri ku ishte prezente edhe Dr.Ingrid Hengster, anëtare e Bordit të Drejtorëve të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW). Të pranishmit u njoftuan me progresin e punimeve në implementimin e projektit si dhe patën rastin që të shohin procesin e shtrirjes së përçuesve elektrik në shtyllat elektrike nr1. dhe nr.2.


Me këtë rast, gjithashtu u nënshkrua edhe kontrata në mes të KOSTT dhe kompanisë austriake SIEMENS e cila do të implementoj punimet në kuadër të LOT-it 4 që janë pjesë e Projektit “Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit, Programi IV dhe V i Sektorit”. Vlera e kontratës prej 8,722,018 Euro bashkë-financohet nga KfW dhe KOSTT. Projekti parasheh rehabilitimin e 19 Nënstacioneve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT).

-Ambasadori i Kroacisë vizitoi në terren punimet në linjën 400 kV Kosovë-Shqipëri

Ambasadori i Kroacisë në Kosovë z.Zoran Vodopija me bashkëpunëtorë, në muajin shtator 2015 realizoi vizitë në terren punimeve në linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri. Me këtë rast delegacioni pati rastin që të shohë punimet në finalizimin e ngritjes së shtyllës së fundit elektrike në kuadër të projektit, mu pranë kufirit Kosovë-Shqipëri në Qafë Morinë. Ambasadori Vodopija u shpreh shumë i kënaqur për realizimin e suksesshëm të punimeve dhe cilësinë e punës nga ana e kompanisë kroate Dalekovod, e cila ka implementuar projektin në pjesën e Kosovës.

-Nënshkruhet Marrëveshja për Kyçje të Sistemit Energjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale, në mes të KOSTT dhe ENTSO-E

Me 1 tetor 2015, në ambientet e organizatës së Operatorëve Evropian të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) në Bruksel, u nënshkrua Marrëveshja për Kyçje të Sistemit Energjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale. Marrëveshja është nënshkruar në mes të KOSTT, si Operator i Sistemit të Transmisionit (OST) të Kosovës në njërin anë dhe ENTSO-E në anën tjetër e përfaqësuar nga 30 OST të Grupit Regional të Evropës Kontinentale. Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Kyçje, KOSTT duhet të filloj operimin si zonë/bllok kontrollues i pavarur në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale. Përveç operimit të sistemit si bllok kontrollues do të bëhet edhe menaxhimi komercial i kongjestionëve në linjat interkonektive të Kosovës, alokimi i kapaciteteve interkonektive (linjat ndërshtetërore), do të realizohen të hyrat nga transiti i energjisë elektrike nëpër rrjetin transmetues të Kosovës, çështje të cilat kanë qenë të hapura tashmë disa vite. Përfundimisht ky proces do të rezultojë me përfitim edhe për konsumatorët e energjisë elektrike të Kosovës dhe industrinë e energjisë elektrike si dhe do të ketë edhe obligime që ndërlidhen me sjelljen e sistemit në përputhje me modin e ri të operimit. Në kuadër të këtij procesi, KOSTT brenda 2 viteve do të vazhdojë të punojë për implementimin e masave teknike për të përmbushur të gjitha standardet teknike të Manualit të Operimit të ENTSO-E, drejt antarësimit në ENTSO-E.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

-Emërohet Kryeshefi Ekzekutiv i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a

Pas një procesi transparent dhe konkurrues në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, në muajin dhjetor 2015 Bordi i Drejtorëve të KOSTT sh.a në mënyrë unanime ka vendosur që të emëroj Kryeshef Ekzekutiv të KOSTT sh.a z.Mustafë Hasani. z.Mustafë Hasani me profesion Magjistër i Shkencave të Administrimit të Biznesit mban përvojë shumë vjeçare në pozita të larta menaxheriale si Drejtor Gjeneral në Administratën Tatimore të Kosovës, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencionit për Promovimin e Investimeve, Drejtor i Bordit të Trafikut Urban, angazhime në projekte të ndryshme të Komisionit Evropian dhe së fundi drejtor i Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat në Ministrinë e Financave. z.Hasani gjithashtu është ligjërues i lëndëve ekonomike në kolegje private në Kosovë.

z.Mustafë Hasani ka marrë udhëheqjen e KOSTT pas pensionimit të z.Naim Bejtullahu.

-Inaugurohet Projekti i Rregullimit Sekondar Kosovë-Shqipëri si dhe përfundimi i punimeve në linjën interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri


Me 17 Dhjetor 2015, në praninë e delegacionit të lartë Qeveritar të Republikës së Kosovës në krye me Kryeministrin e Kosovës z.Isa Mustafa, përfaqësuesve të Qeverisë së Shqipërisë, të Ambasadës Gjermane në Kosovë, Bankës Gjermane për Zhvillim KfW dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare u inaugurua projekti "Rregullimi Sekondar Frekuencë/Fuqi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë si dhe përfundimi i punimeve në linjën interkonektive 400 kV deri në kufirin me Shqipëri. Projekti për ndërtimin e linjës interkonektive Kosovë-Shqipëri ka përfunduar 2 muaj para afatit kontraktual. Implementimi i LOT 1 është realizuar nga kompania kroate Dalekovod ndërsa implementimi i LOT 2 nga kompania gjermane ABB.

Në kuadër të ceremonisë u firmos edhe kontrata tregtare për Rregullim Sekondar në mes të KOSTT dhe OST Shqipëri.

-Përgjegjësia Shoqërore Korporative/Corporate Social Responsibility

Gjatë vitit 2015, në kuadër të përkushtimit të Kompanisë për të ndikuar në mirëqenien e komunitetit si një nga parimet e përgjegjësishë shoqërore të korporatave (PShK/CSR), KOSTT ka zhvilluar dhe implementuar projektin më të madh të KOSTT në fushën e PShK/CSR. Në kuadër të këtij projekti është përkrahur komuniteti i 8 komunave përgjatë së cilave shtrihet traseja e linjës ndërshtetërore 400 kV Kosovë-Shqipëri, përkatësisht komunat: Kastriot, Vushtrri, Drenas, Malishevë, Rahovec, Gjakovë, Deçan dhe Junik. Rrjedhimisht, nga buxheti i përgjithshëm prej 40.000 Euro, janë ndarë nga 5 000 EUR për secilën Komunë. Projektet për të cilat është përkrahur komuniteti i Komunave në fjalë janë:


Komuna e Deçanit	Ndërtimi i infrastrukturës së kanalizimit në Shkollën fillore "Dëshmorët e Baballoqit", Baballoq, z.k.Gramaçel
Komuna e Drenasit	Rregullimi i rrethojës së SHMU "Abedin Bujupi", fshati Gjurgjicë, z.k.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Arllat,

Komuna e Rahovecit	Rregullimi i terrenit sportiv në SHFMU Milaim Krasniqi, fshati Pastasel
Komuna e Gjakovës	Rregullimi i nyjave sanitare në shkollën fillore Shtjefën Kurti, fshati Novosellë e Epërme
Komuna Malishevë	Rregullimi i oborrit të shkollës fillore “Tafil Kelmendi, fshati Balincë
Komuna Vushtrri	Ndërtimi i pikave pritëse për autobusë në rrugët lokale të fshatrave nga kalon linja
Komuna Junik	Hapja dhe instalimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen Kallavaj
Komuna Obiliq	Ndriçimi publik i rrugëve në fshatin Milloshevë

Kriteret për përkrahje të Komunave kanë qenë: 1. projekti të jetë në funksion të komunitetit; 2. përfitues të drejtpërdrejtë të jenë qytetarët/komuniteti i një apo më shumë fshatrave të Komunave përgjatë së cilave shtrihet linja 400 kV Kosovë-Shqipëri.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 28 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>	

3.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

2.3.1 Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për Janar-Dhjetor 2015

Muajt MWh	Janar-Dhjetor 2015		
	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
(1) TC Kosova A	1 927 016	1 905 371	98.88
(2) TC Kosova B	3 833 085	3 582 170	93.45
(3) Energjia për shpenzime vetanake (TC A+TC B)			
(4) HC Ujmani	84 000	103 305	122.98
(5) HC Lumbardhi I kyçur në Distribucion	26 501	18 903	71.33
(5*) HC Lumbardhi i kyçur në Transmision		4 501	
(6)= 1+2+3+4+5 Prodhimi në hyrje të transmisionit	5 844 101	5 595 347	95.74
(7) Devijimi		19 507	
(8) Eksporti	499 208	628 299	125.86
(9) Importi	507 960	715 318	140.82
(10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim	5 852 853	5 662 859	96.75
(11) Distribucioni	4 742 845	4 496 466	94.81
(12) Ferronikeli	631 978	584 855	92.54
(13) Sharri	65 750	63 480	96.55
(14) Trepça	25 850	23 970	92.73
(15) Mihjet dhe konsum.jasht KEK	138 000	129 744	94.02
(16) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45)	134 093	254 331	189.67
(17) = 11+12+13+14+15+16 Kërkesa neto	5 738 516	5 552 847	96.76
(18) Humbjet në transmision	114 337	110 012	96.22
(19) =17+18 Kërkesa gjithsej	5 852 853	5 662 859	96.75

Shpjegim: Siç shihet nga tabela, humbjet në transmision në vitin 2015 kanë qenë për 3.8% më të ulëta se ato të planifikuara, ndërsa për 0.9% më të ulëta se humbjet e lejuara nga ZRRrE, të cilat janë lejuar në lartësinë prej 110.9 GWh.


(3) Energjia për shpenzime vetiake nga (TC A dhe TC B) e cila hyn në rrjetin e transmisionit është e barabartë me energjinë që termocentralet e marrin nga rrjeti i transmisionit për shpenzime vetiake (16). Rreshti (3) në tabelë në vlerat e realizuara është e përfshirë në pikën (6)- Prodhimi në hyrje të transmisionit.

Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2015.


Të dhënat e realizuara janë nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.


****** HC Lumëbardhi Nga data 11 Shtator, është kyçur në nivelin e transmisionit 110/35kV.

Të dhënat në tabelë janë ilustruar në diagramin vijues:




Diagrami i balancës së realizuar elektroenergjetike Janar-Dhjetor 2015 (GWh)



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 31 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

Nr	Indikator		Janar-Dhjetor 2014	Janar-Dhjetor 2015	2015/2014(%)	Caku	Komenti
T1	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)						Do të aplikohet kur KOSTT fillon të funksionojë si zonë rregulluese
T2	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC						Do të aplikohet kur KOSTT fillon të funksionojë si zonë rregulluese
T3	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/periudhën e raportimit)		145,5	178,9	122,9	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhën aktuale)/(AIT për periudhën e kaluar) < 1	AIT ka qenë më e madhe gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015 për 22.9%. Energjia e pa furnizuar ka qenë më e lartë për shkak të projektit të ndërtimit të linjës 400kV Kosovë B-Tirana 2, që ndikon në rritje të AIT.
T4	Numri i ankesave për tension		3	0	0	Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhën e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtër.


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 32 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T5	Numri i ankesave për matje		0	0	0		
T6	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	22,46	20,18	89,85	30MWh/h tërheqje jashtë programit të deklaruar	Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve, të jenë sa më të vogla.
		Eksport	20,39	22,96	112,62	30MWh/h shtyrje jashtë programit të deklaruar	
T7	Humbjet në transmision (GWh)		108,83	110,02	101,09		Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë për 1.09 % më të larta në periudhën Janar-Dhjetor 2015 krahasuar me periudhën e njëjtë 2014, për shkak se energjia e transmetuar ka qenë më e lartë për 3,57%.
T8	Energjia e transmetuar (GWh)		8234,56	8528,68	103,57		Energjia e transmetuar ka qenë për 3,57% më e lartë që do të thotë se prodhimi dhe hyrjet nga interkoneksioni kanë qenë më të larta.
T9	Gjatësia totale e linjave (km)	400 kV	188,49	279,5	148,28		Ndërtimi i LP 400kV Kosovë B-Tirana 2
		220 kV	231,83	231,83	100,00		
		110 kV	776,336	811,7	104,56		Hyrje-Dalje e LP 1806/1&1806/2 në Gjakovë 1

AATC-Average Available Transmission Capacity

MATC-Maximum Available Transmission Capacity


$AIT = (8760 * 60 * ENS) / TE$

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 33 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pa furnizuar


TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar (Energjia që hyn në transmision) është energjia e cila hyn në transmision nga prodhimi i gjeneratorëve (Prodhimi në prag të transmisionit) dhe importeve si rrjedha fizike nga linjat interkonektive (import flow).

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve (minuta/periudha e raportimit)


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit

Nr	Indikator	Niveli i tensionit	Mesatarja 5 vjeçare (2009-2015)	2015	Krahasimi	Caku	Komenti
		kV		Janar - Dhjetor 2015	2015/ mesataren (%)	<= 1	
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.18	0.53	0		
		220	0.86	0.43	0.55		
		110	1.75	0.86	0.81		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	0.31	2.24	0		<ul style="list-style-type: none"> - LP-205/1 ndërrimi I izolator polimeri ne shtyllën 57B - LP-437/1 Përçuesi mbrojtës i këputur, - Këputje e përçuesit fazor në LP-164/2, LP-179/2, LP-118/5 nga bora. - LP164/2 ka qëndruar jashtë pune për një kohë prej më shumë se 78 orë, si pasojë e dëmtimit të shtyllës nr.16 në këtë linje. Ky rast duhet të trajtohet si incident në punë.
		220	2.20	2.34	1.17		
		110	7.33	84.89	7.7		
T3	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0.00	0	0		
		220	0.00	0	0		
		110	0.11	0	0		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 35 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	0.00	0	0	<= 1	
		220/110	8.53	0	0		
		110/35/10	15.38	24	0.84		
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0.00	0	0	> 1	- Problemet me bushingun e TR1 në NS Gjakova 1 për një kohë të gjatë.
		220/110	0.98	0	0		
		110/35/10	1.28	14.75	2.7		
T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.27	0	0		
		220/110	0.17	0	0		
		110/35/10	0.00	16.81	3.7		
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	6.67	0	0		
		220	10.28	0	0		
		110	9.72	0	0		
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	2.54	0	0		
		220	2.92	0	0		
		110	5.06	0	0		
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0.00	0	0		
		220	0.00	0	0		
		110	1.06	0	0		
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	5.00	0	0		
		220	3.90	0	0		
		110	2.25	0	0		
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje	400	1.40	0	0		
		220	2.60	0	0		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 36 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

	rele/kontroll (orë)	110	1.93	0	0		
T12	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0.00	0	0		
		220	0.00	0	0		
		110	0.00	0	0		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 37 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.4. Operimi i tregut

2.3.4.1 Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral dhe i rregulluar ku mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.

Për shkak të mungesës së konkurrencës dhe furnizuesve të tjerë të pavarur dhe në bazë të ligjeve të reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Feronikeli furnizohet nga KESCO me çmim të rregulluar në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të rregulluar në nivelin 220kV do të paraqitet si raport i energjisë së konsumuar në nivelin 220kV në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë e shprehur në diagramet më poshtë.


Në krahasim me vitin 2014 në vitin 2015 kemi rritje të humbjeve nga 108.831MWh në 110.011MWh.

Tranziti i energjisë elektrike në periudhën Janar-Dhjetor' 15 në rrjetin e KOSTT ka qenë 2.136.123 MWh gjegjësisht 26% e rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues. Edhe më tutje KOSTT nuk kompensohet për këtë shërbim nga mekanizmi i ITC por kompensohet EMS (TSO e Serbisë).


Sipas vlerësimeve të KOSTT, energjia elektrike e reduktuar në vitin 2015 është mesatarisht 1.04% e konsumit vendor, nga 1.45% sa ishte në vitin 2014.

Konsumi tarifor në nivelin me pakicë në vitin 2015, i furnizuar nga rrjeti 110kV, ka qenë 4.607.182MWh apo 82.62% i konsumit total ta dalë nga rrjeti transmetues që ishte 5.634.482MWh.

Tregu i rregulluar dhe pa-rregulluar




Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues



Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision

Pjesëmarrja e konsumit tarifor dhe jo tarifor



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 39 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet

Draft Bilanci i Gjendjes


31.12.2015

	Note	VIT (2014) EUR	VITI(2015) EUR
PASURITË JO QARKULLUESE			
Palujtshmëritë, impiantet dhe pajimet	4	115,400,314.85	142,070,571.35
Investimet në vijim	5	15,137,019.94	14,835,528.31
PASURITË QARKULLUESE		130,537,334.79	156,906,099.66
Stoqet, pjesët rezervë dhe veglat	6	2,603,982.66	3,344,910.49
Arkëtueshmëritë dhe kërkesat tjera	7	2,928,568.50	5,396,512.38
Huatë, avanset dhe depozitat	8	8,198,891.39	6,624,454.78
Paradhëniet për tatimin në fitim			488,559.58
Paraja në arkë dhe bilanci bankar	9	23,508,522.02	26,435,950.27
		37,239,964.57	42,290,387.50
		167,777,299.36	199,196,487.16
KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT			
Kapitali aksionar	10	25,000.00	25,000.00
Kapitali i trashëguar	11	53,322,441.72	53,322,441.72
Fitimi për periudhën e mëhershme		18,714,326.22	23,085,349.17
Fitimi i mbajtur i vitit		4,371,022.95	8,086,283.59
		76,432,790.89	84,519,074.48
DETYRIMET JO KURENTE			
Të hyrat e shtyera	12	82,416,842.55	89,275,137.41
DETYRIMET KURENTE			
Pagueshmëritë dhe obligimet tjera	13	8,927,665.92	9,360,643.93
Kreditë afat gjate jashtë vendit.	14		16,041,631.34
		91,344,508.47	114,677,412.68
		167,777,299.36	199,196,487.16

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 40 nga 87</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

DRAFT PASQYRA E TË ARDHURAVE

	Realizimi Janar-Djetor 2014	Buxheti Janar- Dhjetor 2015	Realizimi Janar- Dhjetor 2015	realizimi ndaj buxhetit	realizimi 2015/2014
Të hyrat nga rrjeti 220 /400 kV	521,338	556,036	556,036	100%	107
Të hyrat nga rrjeti 110 kV	13,322,003	14,669,904	14,669,904	100%	110
Të hyrat nga sistemi i operimit	4,704,971	8,771,498	8,299,581	95%	176
Të hyrat nga operatori i tregut	297,099	370,165	335,205	91%	113
Gjithësejt të hyrat nga tarifat	18,845,411	24,367,603	23,860,727	98%	127
Të hyrat tjera operative	40,044	30,000	39,437	131%	98
Të hyrat nga interesi	480,613	100,000	284,196	284%	59
Të hyrat e shtyera	6,398,506	6,100,000	6,406,836	105%	100
Gjithësejt të hyrat	25,764,573	30,597,603	30,591,197	100%	118.7
Shpenzimet operative	10,680,904	14,259,200	12,099,808	85%	113
1 Mirëmbajtja	812,772	752,000	611,760	81%	75
2 Shpenzimet e stafit	5,014,130	5,223,000	5,102,579	98%	102
2.1 Pagat	4,778,438	4,600,000	4,528,080	98%	95
2.2. Kontrata në vepër	91,878	120,000	97,643	81%	106
2.3 Përformanca e planifikuar	143,815	503,000	476,856	95%	332
3 Shpenzimet tjera operative	1,791,171	1,679,200	1,717,775	102%	96
4 Rregullimi sekondar	-	3,419,000	-	0%	
5 Humbjet në bartje	3,062,830	3,186,000	3,075,667	97%	100
6 Shpenzimi i tatimit në fitim dhe Tvsh-së			1,592,027		
Fitimi para amortizimit	15,083,670	16,338,403	18,491,389	113%	123
Amortizimi	10,051,889	10,400,000	10,405,106	100%	104
Gjithësejt shpenzimet (operative+amortiz	20,732,793	24,659,200	22,504,913	91%	108.5
Fitimi para tatimit	5,031,780	5,938,403	8,086,283		
Tatimi në fitim	660,758				
Neto Fitimi / Humbja	4,371,023	5,938,403	8,086,283		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 41 nga 87</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Draft Pasqyra e të Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2015

	Viti Paraprak (2014)	Viti i Tanishëm (2015) EUR
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE		
Fitimi gjatë vitit	5,031,780.46	8,086,283.59
Përshtatjet për:		
Provizionimi i stoqeve		
Të hyrat nga interesi	(480,612.90)	(284,195.92)
Shlyerja e mjeteve themelore.	2,000.00	
Amortizimi i paluajtshmërive, impianteve dhe pajisjeve	10,051,889.09	10,405,105.57
Të hyrat e shtyera	(6,399,469.08)	(6,406,836.50)
Rrjedha operative e parasë para lëvizjeve në kapitalin punues	8,205,587.57	11,800,356.74
Rritje e Stoqeve nga Grantet		
Rritje në stoqe, pjesë rezervë dhe vegla	(10,000.00)	(740,927.83)
Rritje në Arkëtueshmëri dhe kërkesa tjera	95,000.00	(2,717,666.62)
Rritje në hua, avanse dhe depozite	(5,249,000.00)	983,949.01
Rritje në pagueshmëri dhe obligime tjera	6,313,000.00	(432,978.01)
Gjenerimi i parasë nga aktivitetet operative	9,354,587.57	8,892,733.29
Pagesa e tatimit në të hyra		
Paraja neto nga aktivitetet operative	9,354,587.57	8,892,733.29
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTIVE		
Të hyrat nga BK-donacion kesh		
Pagesa e donacioneve-.GRANT	5,928,000.00	13,617,511.17
Intersi i pranuar	480,612.90	284,195.92
Blerja e aseteve të reja	(13,759,000.00)	(19,867,012.14)
Paraja neto nga aktivitetet investive	(7,350,387.10)	(5,965,305.05)
Rritja neto e parasë dhe ekuivalenteve të parasë	2,004,200.47	2,927,428.24
Paraja dhe ekuivalentet e parasë me (2014-12-31)	21,507,253.13	23,508,522.02
Paraja dhe ekuivalentet e parasë me (2015-12-31)	23,511,453.60	26,435,950.26

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 42 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2015

	Kapitali aksionar	Kapitali i trashëguar		Fitimi mbajtur	Fitimi i Total
	-----	EUR -----			
Kapitali aksionar në para	25,000.00				25,000.00
Kontributet tjera jo para		53,172,441.73	150,000.00		53,322,441.72
Fitimi për periudhën e mëhershme				23,085,349.17	23,085,349.17
Fitimi i muajve të mëhershëm					-
Shtesat e share premium					
Fitimi për periudhën e mëhershme				8,086,283.59	8,086,283.59
Bilanci me					
31.12.2015	25,000.00	53,172,441.73	150,000.00	31,171,632.76	84,519,074.48

Informacionet për vitin financiar 2015

Të hyrat operative gjatë vitit 2015 kanë qenë 30,591,197 euro dhe janë për 19% më të larta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet operative (shpenzimet operative dhe shpenzimet e amortizimit) janë realizuar në vlerën prej 22,504,913 euro dhe janë për 8,5 % më të larta në krahasim me vitin paraprak.

Të hyrat e realizuara nga tarifa janë në vlerë prej 23,860,727 euro dhe janë për 27% më të larta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa të hyrat tjera operative në vlerë prej 6,730,469 euro janë për 2.7% më të ulëta se në vitin 2014.

Fitimi para tatimit për vitin 2015 është në vlerë 8,086,283 euro.


Asetet jo qarkulluese janë në vlerën prej 156,906,099,66 euro, pasuritë qarkulluese 42,290,387.50 euro, ndërsa gjithsej pasuria e KOSTT sh.a. në vitin 2015 është 199,196,487.16 euro.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 43 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Kapitali aksionar dhe rezervat janë në vlerën prej 84,519,074,18 euro, detyrimet afatgjata (të hyrat e shtyra) 89,275,137,41 euro dhe detyrimet afatshkurtra 9,360,643.93 euro.

Nga të dhënat e prezantuara, shihet se pasuria e KOSTT është financuar nga:

- 42.4% kapitali i aksionarit
- 44.8% grante qeveritare dhe grante tjera
- 4.7% detyrime afatshkurtra
- 8.1% kreditë afatgjate jashtë vendit

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 44 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare

Në vazhdim, janë dhënë IKP-të që paraqesin performancën financiare të KOSTT-it gjatë vitit 2015.

Treguesit	I-XII 2014	I-XII 2015	Shpjegimet
T1. Fitimi operativ marginal = Fitimi neto / gjithsejtë të hyrat	0.20	0.26	Qëllimi është që të jetë mbi zero . Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese. Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj. Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.
T2. Treguesi i likuiditetit = kapitali punues/detyrimet qarkulluese	4.48	4.64	Përcakton aftësinë e kompanisë për të paguar detyrimet e saj afat shkurta. Sa më e lartë është vlera e këtij treguesi, aq më e lartë është siguria që kompania posedon mjete për të mbuluar borxhet afatshkurta. Treguesi duhet të jetë më i madh se 1 .
T3. Treguesi i qarkullimit të kërkesave= kërkesat *365 ditë/të hyrat	28.25	30.12	Ky tregues është i matshëm në baza vjetore Caku: ≤ 90 ditë
T4. Treguesi i efektit të kapitalit të investuar (ROCE) = fitimi neto/mesatarja e kapitalit të investuar mesatarja e kapitalit të investuar = Total asetet- obligimet	4.15%	4.38	Tregon eficiencën dhe profitabilitetin e investimeve kapitale të kompanisë. Sa më i madh është fitimi operativ marginal, aq më i madh është ky tregues. Caku: > 0

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 45 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

2.4. Progresi me Planin e Biznesit

Për të analizuar progresin e KOSTT me Planin e Biznesit, në vazhdim do të cekem: roli, misioni dhe vizioni.

Roli i KOSTT-it është që të operojë sistemin e transmissioinit dhe tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Përgjegjësitë e KOSTT-it janë përcaktuar me ligjet e energjisë (Ligjin për Energji, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë) dhe në licenca. Po ashtu, përgjegjësi e KOSTT-it është edhe bashkëpunimi me operatorët e sistemit të Evropës Kontinentale në marrëveshjet rajonale dhe më gjerë.

Misioni i KOSTT-it është që:

- Të ofrojë shërbime cilësore duke implementuar teknikat dhe teknologjitë më të avancuara për zhvillimin e sistemit të transmissioinit;
- Të sigurojë transparencë dhe të mos diskriminojë mes shfrytëzuesve të sistemit të transmissioinit në një treg konkurrues të energjisë elektrike;
- Të promovojë qëndrimet e kompanisë në nivel rajonal dhe evropian.

Në përputhje të plotë me vizionin e vet, KOSTT synon që “Të jetë kompani financiarisht e qëndrueshme dhe fitimprurëse, e cila siguron transmetimin e sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, e përgjegjshme në kuptim social dhe mjedisor dhe e integruar me rrjetet dhe institucionet evropiane të transmissioinit të energjisë elektrike“.

Për të realizuar synimet e përcaktuara, janë vendosur edhe objektivat strategjike, të cilat para së gjithash kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT-i është një organizatë efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

Objektivat e vendosura të KOSTT për vitin 2015 janë:

1. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit transmetues të energjisë elektrike;
2. Avancimi i mirëmbajtjes dhe operimit të sistemit të transmissioinit;
3. Siguria dhe besueshmëria e sistemit të transmissioinit;
4. Krijimi i kushteve për operimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në pajtim me zhvillimet e pritura;
5. Qëndrueshmëria financiare;
6. Pjesëmarrja aktive në proceset e zhvillimit të tregut rajonal (të përfitojë nga zhvillimi rajonal dhe të kontribuojë në të);
7. Zhvillimi i tregut të përbashkët Kosovë – Shqipëri;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 46 nga 87</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

8. Anëtarësimin në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
9. Funksionalizimi i zonës rregulluese/bllokut rregullues të KOSTT dhe implementimi i aranzhmaneve që ndërlidhen me operimin e sistemit dhe tregut në interkoneksion;
10. Vendosja e marrëdhënieve efektive me palët e interesit;
11. Të jetë punëdhënës atraktiv, që investon në zhvillimin profesional të punonjësve të vet;
12. Të jetë kompani e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor;
13. Të krijojë një ambient të sigurt pune;
14. Optimizimi i punës së sistemit dhe efienca.

Duke marrë për bazë objektivat e lartcekura, do të analizohen edhe të arriturat e KOSTT gjatë vitit 2015, respektivisht, implementimi i këtij Plani të Biznesit.

Gjatë vitit 2015, janë realizuar 97 % të aktiviteteve të ekipeve të mirëmbajtjes së linjave dhe 89% të mirëmbajtjes së nënstacioneve. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i linjave dhe nënstacioneve, remontet e linjave dhe transformatorëve, shqyrtimi i rregullt i fushave, termografia, gazokromatografia, shqyrtimet e mbrojtjeve rele, zëvendësimi i pjesëve dhe pajisjeve të domosdoshme në sistem, si dhe aktiviteteve të planifikuara të mirëmbajtjes si pjesë e zhvillimit të projekteve dhe komisionimeve të tyre.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera jashtë aktiviteteve të planifikuara, si: realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve, analizimi i prishjeve, specifikimet teknike, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për vlerësimin e ofertave, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për pranim teknik, pjesëmarrja në implementimin e projekteve të ndryshme në Kostt etj. Të gjitha këto aktivitete kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operatorit të transmisionit, sidomos në nënstacione të cilat llogariten si intervenime preventive ,ku si aktivitete në tërësi përbëjnë 26 % e aktiviteteve të planifikuara, gjë që është arritur duke optimizuar në maksimum ekipet në terren.

KOSTT me aktivitetet e ndërmarra që nga kalimi i aseteve nga KEK në KOSTT, ka arritur që të ketë një siguri shumë më të lartë të operimit të transformatorëve energjetikë 110/35/10 kV dhe mund të thuhet se tani e kemi një pasqyrë shumë të qartë mbi gjendjen e tyre dhe mënyrën e eksplotimit të tyre në të ardhmen, falë qasjes profesionale të stafit të mirëmbajtjes në shqyrtimet dhe aktiviteteve tjera të nevojshme të mirëmbajtjes. Kësaj i ka kontribuar strategjia e KOSTT për avancimin profesional të punëtorëve përmes

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 47 nga 87</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

trajnimeve adekuate, si dhe krijimi i kushteve më të mira për punë duke u ofruar gjithë pajisjet dhe makinerinë e nevojshme për kryerjen e punëve në mënyrë sa më profesionale. KOSTT do të vazhdojë edhe më tutje në ngritjen profesionale të stafit të mirëmbajtjes për teknologjinë e re në nënstacione dhe situatën e re të krijuar në linja, pas investimeve në linja të dyfishta si dhe kompletimin më tutje të pajisjeve të nevojshme.

Gjatë viteve 2014-2015, Banka Botërore ka ofruar një pako mbështetje konsultuese për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) të Kosovës dhe KOSTT-in, në kuadër të një granti nga Ndërmarrja Këshilluese për Infrastrukturë Publike-Private (PPIAF). Kjo mbështetje ka për qëllim lehtësimin e shkëmbimit më efektiv të infrastrukturës në mes të Sektorit të energjisë dhe atij të telekomunikacionit, ku përfshihen dokumentet dhe prezantimet, të përgatitura nga konsulencia Deloitte, si:

1. Operacionalizimi i shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës telekomunikuese të KOSTT-it
2. Hartimi i modelit të kostos dhe analiza sensitive për vlerësimin e kostove për shërbime të infrastrukturës telekomunikuese të KOSTT-it,

KOSTT tashmë ndodhet në shqyrtimin e mundësive tekniko ekonomike dhe legale për të filluar ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës telekomunikuese. Për të ngritur kapacitetin për hapat e ardhshëm, Banka Botërore ka angazhuar një konsulent internacional, që në afat sa më të shkurtër të suportoje implementimin e këtij biznesi të ri.

Nga aspekti i sistemeve SCADA/RTU janë bërë një varg ndërhyrjesh në riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemeve të SCADA-ve ekzistuese si ndërrimin e HMI-ve, monitorëve, BCU-ve, përfshirjen e të dhënave të reja në SCADA lokale në pajtim me llojet e pajisjeve primare të zëvendësuara. Është bërë edhe testimi periodik i funksionalitetit të Qendrës Emergjente Dispečerike, i cili ka rezultuar me sukses.

Janë bërë edhe shumë veprime të tjera të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së sistemit, të cilat janë dhënë në vijim:

- Sigurimin i funksionalitetit të plotë të Qendrës Nacionale Dispečerike Emergjente (rezervë),
- Krijimi i kushteve të interkonektimit me fibër optik me TSO-on e Maqedonisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë, për realizimin e komunikimeve inter-TSO,
- Funksionalizimi i plotë i qendrës për menaxhimin dhe monitorimin në kohë reale të infrastrukturës telekomunikuese NMS (Network Management System), kryesore në QND dhe asaj rezervë në QNDE, si dhe i radio sistemit telekomunikues,
- Instalimi i 20 RTU-SCADA sistemeve në nënstacione 110 kV/X kV, të cilat së bashku me sistemet ekzistuese të SCADA e furnizojnë me të dhëna sistemin SCADA/EMS,
- Revitalizimi i NS Prizreni 2 (tipit Alstom/Schnider)

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 48 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

- Përgatitjet për mundësimin e monitorimit të NS Prishtina 7
- Është bërë rindërtimi i TS Gjakova 1 me SCADA të re dhe pajisje primare të reja nga ana 110kV (tipit Schneider), që inkorporimi në Qendrën Dispečerike është bërë nga vetë inxhinierët e KOSTT-it (SCADA RTU),
- Në NS Skenderaj dhe NS Burimi janë në rindërtim shtimi i nga një trafo 110kV/10kV, ku po bëhet edhe shtimi i pajisjeve për kontroll dhe inkorporimi në SCADA EMS.
- Ka vazhduar gjatë tërë vitit implementimi i projektit SCADA LFC në kuadër të linjës 400kV Kosovë – Shqipëri.
- Montimi i modemeve me adapterë për komunikim përmes rrjetit fibër optik,
- Me ndihmën e inter-fejseve (ndërlidhjeve) TCP/IP dhe rrjeteve ethernet, është mundësuar integrimi HVM në rrjetet lokale të KOSTT, duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (GSM) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre,
- Me ndihmën e inter-fejseve TCP/IP, rrjeteve ethernet dhe centralit telefonik IP, është mundësuar gjithashtu integrimi i gati të gjitha objekteve elektroenergjetike në rrjetin lokal telefonik të KOSTT – VOIP (Voice over IP), duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (PTK) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre,
- Testimi periodik i njehsorëve dhe verifikimi i klasës së saktësisë të tyre,
- Përshtatja e sistemeve matëse me Kodin e Matjeve,
- Mirëmbajtja dhe leximi i të dhënave të matura për barazim përfundimtar nga njehsorët në Qendrën për lexim nga distanca(RMC-AMR), si dhe
- Administrimi dhe Operimi në RMC (Remote Metering Center), llogaritja dhe analiza e humbjeve teknike në transmision.

Investimet e realizuar në Rrjetin e transmisionit gjatë vitit 2015 kanë ndikuar në arritjen e objektivave të KOSTT përmes rritjes së sigurisë në sistemit Elektroenergjetik , plotësimin e kushteve teknike sipas ENTSO – E etj.

Statusi i projekteve kapitale për vitin 2015:

- 1) Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-1 dhe LOT 2:SCADA/EMS, i financuar nga BK

Statusi i projektit: Projekti deri në Q4 2015 është nën afatin e mirëmbajtjes, si pjesë e kontratës;

- 2) Shërbimet konsulente dhe Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1, financuar nga KfW (donacion) dhe KOSTT (kredi) ;

Statusi i projektit: Më 14.12.15 projekti ka përfunduar , Në proces është përmbyllja e aktiviteteve të fundit administrative. Mbetet që të përcillet eliminimi i vërejtjeve të dhëna nga Komisioni për Pranim Teknik Intern. Progresi i gjithmbarshëm është rreth 99.00%. Projekti është përfunduar dy muaj para

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 49 nga 87</i>
Departamenti Financiar		Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

kobe, bazuar në kontratën e nënshkruar; Vlera e amandamentuar e projektit është 29,280,281.79 € (pa taksa doganore dhe TVSH). Pagesat nuk janë realizuar komplet; mbetet një pjesë për vitin 2016;

3) Shërbimet konsulente & Ndërtimi i linjës 400 kV Fusha e TL dhe LFC - LOT 2 financuar nga KfW (donacion) dhe KOSTT (kredi);

Statusi i projektit: Me 14.12 .2015 bashkë me projektin e Linjës 400kV ka përfunduar edhe projekti i LFC . Projekti është përfunduar dhe objektet/pajisjet janë energjizuar më datën 14.12.2015. Në proces është përmbyllja e aktiviteteve të fundit administrative. Mbetet që të përcillet eliminimi i vërejtjeve të dhëna nga Komisioni për Pranim Teknik Intern. Janë kryer rreth 99% te punimeve;

4) Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806, drejtimi NS Gjakova 1 – NS Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

Statusi i projektit: : Projekti pjesa e linjës 1806/1(NS Gjakovë 1 – NS Gjakovë 2) dhe 1806/2 (NS Gjakove 1 – NS Kline) ka përfunduar , me datën 09.12.2015, linjat janë energjizuar. Projekti ka pasur vonesa në implementim, si pasojë e shpronësimit dhe servitutës;

5) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2, LOT 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it

Statusi i projektit: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2, është në fazën e implementimit. Përqindja e punëve elektrike ka arritur 93 %.ndërsa përqindja e punëve ndërtimore ka arritur 87 %. Pritet të përfundoj gjatë Q2 2016;

6) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në dhe Prizreni 3 Lot 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

Statusi i projektit: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Prizreni 3 është në fazën e implementimit. Përqindja e punëve elektrike ka arritur 93 % dhe përqindja e punëve ndërtimore ka arritur 88 %. Pritet të përfundoj gjatë Q2 2016;

7) Revitalizimi i Nënstacioneve NS 110 kV, ana 35 kV (NS Gjakova 1)

Statusi i projektit: Projekti ka përfunduar 01.11.2015 dhe është në fazën garantuese ;

8) Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV – Skenderaj – Burim -it;

Statusi i projektit: Projekti ka vazhduar me implementim dhe pritet përfundimi në vitin 2016;

9) Instalimi i transformatorit TR3 në NS 110/10 (20) kV – Prishtina 2

Statusi I projektit :Projekti është në fazën e implementimit. . Deri më tani janë realizuar punët elektrike në total ~ 70 %, dhe punët ndërtimore rreth 85 %. Bëhet zgjatja e afatit të ekzekutimit të punimeve deri më 18.04.2016, duke marr për bazë vonesat për shkak të pamundësisë së realizimit të shkyjeve ;

10) Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV – Berivojcë dhe Viti

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 50 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Statusi i projektit: Projekti ka përfunduar pjesërisht , punët instaluese , testuese dhe konisionuese kanë përfunduar në NS Berivojë ndërsa në NS Viti vazhdon punët me implementim dhe pritet përfundimi në vitin 2016;

11) Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kos A, i financuar nga buxheti i KOSTT-it;

Statusi i projektit ; Projekti ka vazhduar me implementim dhe në mars të vitit 2015 ka përfunduar . Projekti është në afatin garantues njëvjeçar ;

12) Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes KOSTT/KEDS

Statusi i projektit: Projekti ka vazhduar me implementim në fillim të vitit 2015 . Ka përfunduar pjesa e aprovimit të dizajnit dhe liferimit të pajisjeve ;

13) Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispečerike dhe në Qendrën Emergjente Dispečerike

Statusi I projektit : Projekti është në fazën e implementimit;

14) Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Prizreni 2;

Statusi i projektit: është nënshkruar kontrata; projekti është në fazën e dizajnit ;

15) Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit faza IV &V" kontratë kjo që është e nënshkruar në Q1 2015 dhe është e ndarë në 4 LOT.:

Statusi i projekteve: Projektet kanë filluar me implementim në Qershor 2015 dhe janë në fazën e dizajnit , marrjen e lejes për ndërtim ;

LOT 1: Nënstationet [110/10(20) kV - ne fazën e dizajnit

Ri-vitalizimi i NS Peja 1(GIS)

Ndërrimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4 ;

INTER OST Grupet Matëse në pikat interkonektive ;

Fushat transformatorike 400/110kV në NS Ferizaj2 dhe NS Peja 3;

LOT 2 - Transformatorët - në fazën e dizajnit

Instalimi i auto transformatorit të dytë ATR2, 300 MVA në NS Peja 3 dhe NS Ferizaj 2;

LOT 3 - Linjat transmetuese - në fazën e dizajnit dhe marrjes së lejes së ndërtimit

Linja e re e 110kV e dyfishte NS Peja 3 - NS Peja 1;

Revitalizimi I linjës110kV L126/2 NS Peja 2- NS Decan ;

Instalimi i OPGW në linjat interkonektive;

LOT 4 - Rehabilitimi i nënstacioneve - fazën fillestare të dizajnit

Rehabilitimi I nënstacioneve NS Viti , NS Lipjan , NS Klinë ;

Rehabilitimi I shpenzimeve vetjake AC/DC në nënstacionet 110kV ;

Transformatori I dytë në NS Gjakova 1;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 51 nga 87</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

16) Shërbime të Konsulencës për përgatitjen e tender dosjes për “Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës” të financuara nga BERZH (EBRD).

Statusi i projekteve : në Qershor të vitit 2015 është nënshkruar kontrata për shërbime konsulente. Projekti është në implementim, konform procedurave konsulente ka përgaditur tender dosjen në tre LOT: LOT1 janë përfshirë nënstationet, LOT 2 –transformatorët e fuqisë dhe LOT 3 – linjat transmetuese dhe ato kabllorike për kryqjen e nënstationeve .Është shpallur tenderi, konform Rregullave dhe Politikave të Prokurimit të BERZH-it dhe për kompanitë e interesuara ofertuese është realizuar vizita në teren . Faqja tenderuese është prej Nëntorit 2015 deri Shkurt 2016 (hapja e ofertave) . Afati i dorëzimit të ofertave nga tenderuesit e ndryshëm, përmes platformës elektronike ECEPP (BERZH) (<https://eceppebrd.com>), është 23.02.2016.

Komisioni i Bordit për Investime Kapitale e ka përcjellë statusin e projekteve, gjatë mbledhjeve që janë mbajtur gjatë vitit 2015, me ç ’rast për të gjitha problemet dhe vonesat është njoftuar më kohë dhe ka dhënë rekomandime për Bordin e Drejtorëve se si të veprohet më tutje, për rastet e vonesave në projekte.

Ndërrimi i regjimit të zgjidhjes së çështjeve pronëso- juridike dhe si pasojë e mos përfshirjes së kohës përkatëse për zgjidhjen e tyre në dokumentacionin tenderues, ka shkaktuar vonesa në implementim të një numri të vogël të projekteve.

Gjatë vitit 2015, kanë vazhduar angazhimet në procesin e integritit të KOSTT në mekanizmat Rajonal dhe Evropian, sidomos në procesin e arritjes së marrëveshjeve operative me TSO-të fqinje dhe arritjes së marrëveshjes me ENTSO-E. Në Prill të vitit 2015 ka përfunduar me sukses testimi i Skedulimit (programit të shkëmbimit ndërkuftar) dhe Accounting-ut (barazimit të matjeve interkonektive) me TSO-të fqinje dhe Swiss Grid (Qendra Koordinative e zonës së parë sinkrone), me ç ’rast ka dëshmuar se KOSTT është i aftë t’i kryej këto aktivitete si TSO e pavarur. Ndërsa në nëntor është përsëritur me sukses edhe testimi i linjës virtuale për nevoja të implementimit të Marrëveshjes së shërbimit të rregullimit sekondar ndërkuftar.

Me këtë rast, duhet cekur edhe kontributi i madh në iniciativën për themelimin e tregut të përbashkët Kosovë – Shqipëri, ku KOSTT ka marrë pjesë aktive në takime të ndryshme duke mbajtur prezantime të ndryshme për tregun e përbashkët me ç ’rast ka sqaruar dhe arsyetuar rëndësinë e një tregu të përbashkët dhe përfitimet që ky treg u sjell të dy vendeve.

Kanë vazhduar aktivitetet dhe angazhimet në çështjen e zgjedhjes së kontestit me EMS lidhur me e ITC (transit të energjisë elektrike në rrjetin transmetues) dhe CM (congestion management – menaxhimi i kongestionëve dhe alokimi i kapaciteteve ndërkuftare).

Është implementuar dhe është futur me sukses në operim SME (Sistemin për Menaxhimin e Energjisë) si në aspektin e tregut të brendshëm ashtu edhe në aspektin ndërkuftar me TSO-të fqinje.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 52 nga 87</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

Janë hartuar Procedurat e Rregullave të Tregut: Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-kufitare, Procedura për transferin e konsumatorit, Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit. Këto procedura janë dorëzuar pastaj në ZRrE për miratim.

Në tremujorin e fundit të vitit, janë intensifikuar përgatitjet për implementimin e procesit të Alokimit të Kapaciteteve Transmetuese duke organizuar takime me Tregtarët për t'i njoftuar me procedurat e KOSTT për alokimin e kapaciteteve transmetuese dhe pjesëmarrjen e tregtarëve në ankandin e kapaciteteve transmetuese të organizuar nga OT si dhe trajnime të palëve tregtare (KEK., KESCO) për pjesëmarrje në Ankandin e kapaciteteve transmetuese përmes platformës së tregut.

Në përmbushjen e objektivave, një nga të cilat është edhe integrimi rajonal, KOSTT vazhdon edhe më tutje të ballafaqohet me shumë sfida që paraqiten në procesin e integritimit në mekanizmat rajonal .

Një nga objektivat strategjike të KOSTT është edhe kujdesi për shëndetin e punëtorëve, e cila është realizuar me projektin e sigurimit shëndetësor suplementar për të gjithë punëtorët. Implementimi i sigurimit shëndetësor ka ndikuar në mbajtjen e shëndetit të mirë të punëtorëve, në motivimin e punëtorëve për punë dhe arritjen e objektivës për të qenë punëdhënës atraktiv. Mbrojtja dhe kujdesi për shëndetin e punëtorëve gjithashtu do të ndikojë edhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

Në kuadër të kujdesit shëndetësor si kërkesë obligative ligjore me qëllim të përcjelljes permanente të gjendjes shëndetësore të punëtorëve, hyjnë edhe kontrollet sistematike mjekësore, të cilat janë realizuar nga shumica e punëtorëve e sidomos atyre në vendet e punës në kushte specifike.

Për qëllim të arritjes së objektivave të saj KOSTT, gjithmonë është orientuar në krijimin e kushteve sa më të mira të punës për të gjithë punëtorët e saj. Për këtë qëllim janë realizuar shumë projekte të cilat do t'i mundësojnë një vend pune në të cilën ata do të ndihen më mirë në realizimin e detyrave të tyre dhe arritjen e një performance më të mirë. Duke pasur parasysh këtë, investimet janë bërë duke filluar prej rregullimit të zyrave dhe ambientit tjetër të punës në të gjitha objektet e KOSTT. Kujdes i veçantë i është kushtuar mbrojtjes së mjedisit - duke larguar materialet e rrezikshme për shëndetin nga fasada e Ndërtesës Afariste si dhe nga objektet tjera; Eficiencës së energjisë – duke përdorur materiale termike, ndriçimit eficient dhe burimeve alternative të energjisë - duke vendosur panelet solare, si dhe krijimit të hapësirave të reja për punë dhe hapësirave të gjelbëruara në NS - duke krijuar kushtet më të mira për të gjithë punëtorët e saj, në harmoni me standardet më të larta.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 53 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

KOSTT i kushton kujdes të veçantë sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, sigurisë së aseteve dhe menaxhimit mjedisor duke përmbyshur: furnizimin me pajisje mbrojtëse; informimin dhe përkrahjen gjatë implementimit të sistemit të ri të dokumentacionit për zbatimin e procedurave për punë të sigurt gjatë mirëmbajtjes për linja, nënstacione dhe për kontraktues; inspektimin/monitorimin në teren të objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes dhe procesin gjatë realizimit të projekteve; largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese; angazhimin mbi zhvillimin e projektit për siguri dhe mjedis dhe sipas planit zhvillimor; zhvillimin e dokumentacionit për menaxhimin e sistemit të sigurisë dhe shëndeti në punë si dhe sistemin e menaxhimit të mjedisit si: lëndimet në punë, transporti dhe bartja e ngarkesave, ndikimi i rrymës elektrike në trupin e njeriut, rregullat dhe masat e sigurisë gjatë punës në objekte elektroenergjetike-versioni 2.0, ndihma e parë në vendin e punës, Manuali mjedisor- edukativ, procedurat për veprimet korrigjuese dhe parandaluese për aspekte mjedisore; zhvillimi dhe mbajtja e programeve trajnuese për punëtorë si: rreziku nga rryma elektrike dhe realizimin e tokëzimit në vendin e punës, rreziku nga lartësitë – Ngjitja në shtylla dhe puna në linja ajrore, menaxhimi i mjedisit-mbrojtja e mjedisit dhe rreziqet fizike dhe kimike; bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale etj.

Edhe këtë vit, ka KOSTT ka vazhduar me krijimin e hapësirave të reja për punë dhe hapësirave të gjelbëruara në NS, duke rinovuar Ndërtesat komanduese në NS Vushtrria 1, NS Vushtrria 2, NS Prishtina 5, etj. gjithë që tregon se edhe më tutje ka vazhduar përkujdesja ndaj ambientit të punës në tërësi.

Është realizuar integrimi i rrjetave të NS 110kV/x me rrjetin e KOSTT përmes infrastrukturës komunikuese, si dhe ka filluar implementimi praktik i projektit DMS (Sistemit për Menaxhimin e Dokumentacionit) dhe Arkivës Elektronike.

KOSTT, si edhe deri më tani, ka dëshmuar përgjegjësinë e saj nga aspekti social, duke ofruar mbështetje financiare për shkollim, duke siguruar bursa për studentë dhe mbështetje financiare për kryerjen e praktikës profesionale për studentë. Edhe këtë vit KOSTT dhe FIEK (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike) kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi për implementimin e praktikës profesionale, veçanërisht për studentet e fakultetit të inxhinierisë elektrike duke iu ofruar mundësinë e punës praktike në KOSTT në harmoni me programet adekuate, i cili bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje. Po ashtu, është investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve me realizimin e trajnimeve, pjesëmarrjen në seminare, workshope dhe grupe punuese.

Ndërlidhur me procesin e menaxhimit të cilësisë, KOSTT ka zhvilluar sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe ka implementuar me përpikëri kërkesat sipas standardit ISO 9001:2008, përfshirë të gjitha NS-të e KOSTT. Ky standard është mbikëqyrur nga

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 54 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

kompania certifikuese. Implementimi i kërkesave të standardit ISO 9001:2008 verifikohet me Raportin e auditimit të jashtëm pa asnjë vërejtje dhe sugjerim.

KOSTT-i operon brenda një kornize rregullative të bazuar në ligje, licenca dhe në legjislacionin sekondar të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRrE).

Të gjitha dokumentet, raportet e rregullta dhe të dhëna apo raporte sipas kërkesave të ZRRrE-së dhe të MZHE-së, janë dërguar në afatin e paraparë.

Nga perspektiva e Planit të Biznesit, aspekti më i rëndësishëm rregullativ është përcaktimi i të hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave nga ana e ZRRrE-së. Në bazë të Rregullit për Vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, KOSTT ka dorëzuar te ZRRrE propozimin për të Hyrat Maksimale të lejuara për vitin 2015, si dhe aplikacionin për tarifa që do të zbatohen gjatë vitit relevant tarifor.

KOSTT sh.a si kompani publike dhe e rregulluar, vend të veçantë në veprimtarinë e përditshme i kushton transparencës, dialogut të hapur dhe konstruktiv me publikun si dhe përgjegjësisë ndaj aksionarit dhe palëve të tjera të interesit. KOSTT edhe këtë vit ka vazhduar me raporte korrekte si dhe ka implementuar aktivitete të cilat kanë pasur ndikim në përforsimin e raporteve me palët e interesit në vend dhe jashtë vendit, si dhe në informimin e drejtë të opinionit publik në lidhje me aktivitetet dhe veprimtarinë e kompanisë.

Gjatë vitit 2015 KOSTT ka vazhduar me angazhimet në fushën e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave (Corporate Social Responsibility) të cilën e konsideron si një proces përmes së cilës kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm fillimisht përmes mënyrës se si operon duke inkorporuar politikën e biznesit të përgjegjshëm në politikën e brendshme të kompanisë, ushtrimit të veprimtarisë së vet për të siguruar funksionimin e sigurtë dhe të besueshëm të Sistemit të Transmisionit, kujdesin ndaj mjedisit, funksionimin në përputhje me politikën e qeverisjes korporative, kujdesi për zhvillimin dhe trajnimin e punonjësve, ndërkaq theks të veçantë i vë sigurisë në punë gjë që është esenciale për një kompani që ka të bëjë me energji elektrike të tensionit të lartë. Gjatë vitit 2015 KOSTT ka vazhduar aktivitetet përmes rrjetit të bizneseve të përgjegjshme Kosovo CSR Network si dhe ka implementuar disa aktivitete të rëndësishme në këtë drejtim. Në kuadër të projektit për ndërtimin e linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri KOSTT ka implementuar projektin më të madhë të CSR duke përkrahur komunitetin e 8 komunave përgjatë së cilave shtrihet traseja e linjës ndërshtetërore 400 kV Kosovë-Shqipëri, përkatësisht komunat: Kastriot, Vushtrri, Drenas, Malishevë, Rahovec, Gjakovë, Deçan dhe Junik. Gjithashtu, përmes projektit “Sistemet e dyfishta të MAK-Duplex Sistemet - Linja 400 kV Kosovë-Shqipëri”, KOSTT ka filluar aplikimin e teknologjisë më të avancuar që aplikohet në Botë për mbrojtje nga korrozioni (MAK) e cila përveç mbrojtjes së dyfishtë të konstruksioneve metalike me sistemin “Duplex” gjithashtu përmban një element tjetër të rëndësishëm mjedisor-eliminimin e ndikimit negativ vizuel të aktiviteteve të KOSTT duke përshtatur ngjyrat e

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 55 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

shtyllave elektrike me karakteristikat e peisazhit. KOSTT ka implementuar këtë iniciativë në 20 km e para të linjës në fjalë, përkatësisht 54 shtylla elektrike.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 56 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2015

Emri i Projektit	Buxheti	Financuar nga	Vlera e Kontratës	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Buxheti Shpenzuar Q1-Q4/2015
<i>SCADA/EMS & Telekom</i>	17,987,563.00	Grant / BK	17,987,563.00	Q4 2009-	Q2-2012	Alstom / Komtel (F/ RKS)	163,946.80
<i>Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1</i>	30,500,000.00 €	KfW / KOSTT (Kredi)	30,773,968.59 (pa taksa e dogana) me taksa e dogana (36,000,000€)	Q4-2013	Q4-2016	Dalekorod d.d.	18,320,038.16
<i>Rregullimi sekondar Kosove - Shqipëri (kFw +Kredi)</i>	5,800,000.00€	KfW/ KOSTT (Kredi)	5,392,964.00 €	Q4 2013	Q4 2016	ABB - AG	3,218,502.83
<i>Shpronësimi i tokave dhe kompensimi i dëmeve për projektet e financuar nga buxheti vetanak i KOSTT-it</i>	1,314,000.00 €	KOSTT	,	Q1 2013	Q4-2017	,	568,730.59
<i>Rialokimi i linjës 110kV , nr.1806 NS Gjakova 1 -Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1</i>	1,500,000.00 €	KOSTT	3,267,253.00	Q2 2011	Q4 2015	Ukab (RKS)/ELSA (Si)	88,966.71€

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 57 nga 87</i>
Departamenti Financiar		Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

LOT1: <i>Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS Gjakova 2</i>	2,100,000.00 €	KOSTT	1,973,912.00 €	Q1 2013	Q3 2016	Ukab	293,230.48
LOT2: <i>Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Prizreni 3</i>	2,100,000.00 €	KOSTT	1,796,234.47 €	Q1 2013	Q3 2016	Ukab	235,039.51
<i>Revitalizimi I nënstacioneve NS 110kV ana 35 kV NS Gjakova 1,</i>	1,000,000.00€	KOSTT	416.577.46€	Q4 2013-	-Q4 2017	NP"MONTEN" dhe NTSH"ELING"	142,000.40
<i>Instalimi I TR 2 ne NS 110/10(20) Skenderaj \$ NS Burim me punët shtese</i>	1,500,000.00€	KOSTT	1,679,626.13€	Q2 2014	Q3 2016	Ukab	354,489.66€
<i>Instalimi i transformatorit TR3 në NS 110/10 (20) kV – Prishtina 2 me punët shtesë</i>	1,150,000.00€	KOSTT	1,096,464.5€	Q4 2014	Q2 2016	MONTEN	666,590.55
<i>Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV – Berivojcë dhe Viti (me punë shtesë)</i>	850,000.00€	KOSTT	713,469.02€	Q2 2015	Q4 2016	N.T.Sh . Monting	497,684.12€

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 58 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

<i>Mbrojtjet Rele të 3 Auto transformatorëve në NS KOSA</i>	70,000.00€	KOSTT	69,455.00€	Q3 2014	Q1 2015	Siemens	59,037.00€
<i>Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEK/OSSH</i>	2,500,000.00€	KOSTT	2,327,240.19€	Q4 2014	Q4 2016	Monten & G3 Inxhinering	964,337.05
<i>Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike</i>	3,300,000.00€	KOSTT	3,270,780.43€	Q1 2014-	Q4 2016	Alstom ,Komtel, Koncar	1,352,368.00
<i>Mbrojtjet Rele të 3 Autotransformatorëve në NS Prizreni 2</i>	65,000.00 €	KOSTT	34,908.46€	Q3 2015	Q2 2016	Ukub	00€
<i>Shërbimet Konsulente për përgatitje të tender dosjes / projekteve shtesë dhe menaxhimin e projekteve (Project preparation consultant)</i>	1,573,833.00€	IPA / KJW / Grant	1,573,833.00 €	Q1 2014	Q4 2018	MVV Decon/Consulectra	370,090.60 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 59 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

<p>LOT 1 =Nënstationet 1. Ri-vitalizimi i NS Peja 1(GIS) 2. Ndërimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4 ; 3. INTER OST Grupet Matëse në pikat interkonektive ; 4. Fushat transformatorike 400/110kV dhe VO1 (496458€)</p>	7,649,547.00€	IPA / KJW / Kredi	7,599,902.00€ + 49,648 €	Q2 2015	Q42018	Siemens . Ag	1,529,909.00
<p>LOT 2 - Transformatorët Instalimi i auto transformatorit të dytë ATR2, 300 MVA në NS Peja 3 dhe NS Ferizaj 2</p>	4,443,000.00€	IPA / KJW / Grant	4,443,000.00 €.	Q2 2015-	Q42018	Koncar (Hr.)	888,600.00
<p>LOT 3 - Linjat transmetuese 1. Linja e re e 110kV e dyfishte NS Peja 3 - NS Peja 1; 2. Revitalizimi I linjës110kV L126/2 NS Peja 2- NS Decan 3. Instalimi i OPGW në linjat interkonektive</p>	8,532,671.00€	IPA / KJW / Grant	8,532,671.00€	Q2 2015-	Q42018	Dalekorod .(Hr)	1,706,539.20

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 60 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

LOT 4 - Projekte shtese 1. Rehabilitimi I nënstacioneve NS Viti , NS Lipjan , NS Klinë ; 2. Rehabilitimi I shpenzimeve vetjake AC/DC në nënstacionet 110kV 3. Transformatori I dytë në NS Gjakova 1	10,794,072.00€	IPA/KjW / Kredit	8,722,018 € Opcionale 2,072,054.00€	Q2 2015	Q4 2018	Siemens Ag	1,308,302.70
ECA garancioni për LOT 1 dhe LOT 4	2,100,000.00€	KOSTT	2,100,000.00€	Q1 2015	Q4 2015	-	1,933,763.38
Shërbimet konsulente për mbështetjen e përgatitjes së propozimit teknik për Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës	800,000.00€	EBRD	389,570.00€	Q 2 2015 -	Q1 2016	MVV Decon/Consullectra	159,429.20€

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 61 nga 87</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Përprojekjet e KOSTT-it, si edhe deri më tani, do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike (të cekura në pikën 2.4. të këtij Raporti), në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin.

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit gjatë vitit 2016, do të jenë:

- Implementimi i Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E;
- Fillimi i operimit të KOSTT si zonë rregulluese/bllok rregullues më vete në përputhje me rregullat e ENTSO-E;
- Implementimi i Marrëveshjes për Rregullim Sekondar me OST;
- Implementimi i marrëveshjeve Ndër- OST me OST-të fqinje;
- Implementimi i Mekanizmit Balancues si kërkesë në Dizajnin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë dhe Rregullave të Tregut;
- Rifreskimi i platformave softuerike ekzistuese, trajnimi dhe edukimi i stafit për përdorimin e tyre. Platformat softuerike si SCADA/EMS, Sistemi për Menaxhimin e Energjisë e Tregut, Kontrolli Frekuencë Fuqi-LFC, analiza e sigurisë së operimit një ditë para i njohur si DACF- (Day Ahead Congestion Forecast), Softuer për mbikëqyrje dhe kontroll në kohën reale, pajisjeve të TL të tipit T 5000, E-TERRA Habitat, do të mundësojnë dhe lehtësojnë kryerjen e aktiviteteve të të gjitha palëve pjesëmarrëse në tregun e energjisë, për të siguruar operim më eficient të sistemit të energjisë elektrike;
- Vazhdimi i investimeve në rrjetin e transmisionit për të arritur standarde të larta të shërbimeve ndaj klientëve dhe ngritja e efijencës së afarizmit financiar;
- Eksploatimi maksimal i infrastrukturës për monitorim dhe kontroll të SEE, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese që më saktësisht konsiston në:
 1. Ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rrjetit transmetues nga Qendra Nacionale Dispečerike Kryesore dhe Emergjente;
 2. Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS;
 3. Kompletimi i krijimit të kushteve teknike për monitorim të ndërsjellë me OST-të fqinje në kohën reale.

Në aspektin e operimit, gjatë planit afatshkurtër do të implementohet edhe projekti i Kontrollit Frekuncë-Fuqi në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë, i cili në mënyrë

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 62 nga 87</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

kuptimplote mund ta ndryshojë regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në tri variante:

- Operimi si dy Bloqe Rregulluese te veçanta me shkëmbim të shërbimeve ndihmëse
- Operimi me dy zona rregulluese të ndara në një Bllok rregullues me Shqipërinë, ose
- Operimi në një zonë të përbashkët në fazat e mëvonshme.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Kyçje mes KOSTT dhe ENTSO-E, ka qenë e paraparë që nga 30 nëntor 2015 KOSTT të fillojë të operojë si Zonë/Bllok Rregullues në kuadër të Evropës Kontinentale. Mirëpo për arsye politike ky proces është prolonguar për një kohë. KOSTT shpreson që nga qershori 2016 do të mund ta ushtrrojë rolin e tij si Zonë/Bllok Rregullues.

Modi i ri i operimit përfshin kryesisht aktivitetet që ndërlidhen me bashkëpunimin e OST-ve të interkonektuara, me qëllim të operimit të sigurt të sistemit. Bashkëpunimi i ngushtë i OST-ve bazohet në parimet e respektimit të rregullave të ENTSO-E. Për të filluar operimin si zonë/bllok rregullues, në vitin 2016, në KOSTT duhet të arrihen dy objektiva kryesore:

- Ngritja e kapacitetit të stafit të Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut për të performuar me punët e reja që ndërlidhen me operimin e KOSTT si zonë/bllok rregullues dhe implementimin e marrëveshjeve operative me ENTSO-E dhe OST-të fqinje, në veçanti me:
 - analizën e sigurisë së punës së sistemit një ditë para;
 - nominimin e programit ndërkufitar dhe programeve të palëve tregtare një ditë para në formë të automatizuar përmes softuerëve adekuatë;
 - krijimin e modelit të sistemit të Kosovës për qëllim të llogaritjeve të parametrave të sigurisë së operimit, veprimi adekuat në rrethana emergjente, përpunimi i planit të ri mbrojtës, alokimin e kapacitetit dhe llogaritja e kongestionëve.
- Investimet në zhvillimin e infrastrukturës që mundësojnë proceset e mësipërme, që janë:
 - Zgjerimi i ndërlidhjeve të rrjetit të Fibrës Optik me OST-të fqinje;
 - Qasja në electronic highway –EHW;
 - Implementimi dhe operimi i SME (Sistemin për Menaxhimin e Energjisë) për të bërë në mënyrë automatike procesimin dhe shkëmbimin e të dhënave me OST-të tjera sipas kërkesave të ENTSO-E;
 - Dërgimi i të dhënave në kohë reale në Qendrën Koordinative të Evropës Kontinentale-Swissgrid, të specifikuar nga PG TSO KOSTT;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>ver. 1.1</i>		<i>faqe 63 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

- Dërgimi i të dhënave dhe monitorimi i një pjese të sistemit transmetues për çështje të sigurisë së operimit të sistemit në KOSTT dhe të sistemeve tjera: OST, MEPSO, CGES sipas kërkesave të ENTSO-E;
- Shkëmbimi i të dhënave me OST-të tjera për qëllim të nominimit të programit dhe barazimit përfundimtar duke përfshirë edhe themelimin e Inicativës Rajonale për Siguri të Koordinuar;
- Shkëmbimi i të dhënave me Zonat/Blloqet Rregulluese fqinje dhe Qendrën Koordinative;
- Marrëveshjet për alokimin e kapaciteteve në baza vjetore, mujore, ditore me OST-të fqinje.

ENTSO-E ka krijuar grupin prej ekspertëve për monitorimin e KOSTT-it në plotësimin e kërkesave nga manuali i operimit (PG TSO KOSTT). Kërkesat janë kryesisht teknike, që ndërlidhen me sigurinë e operimit të sistemit, shkëmbimet tregtare ndërkufitare dhe plotësimi i kriterëve nga paketi i tretë i energjisë të KE.

Objektivat e monitorimit nga ENTSO-E janë:

- Siguria e operimit të sistemit elektro-energetik nga aspekti i rrjetit;
- Siguria e Shërbimeve ndihmëse;
- Ndryshimet e nevojshme rregullative që kërkohet nga paketi i tretë i legjislacionit të Komisionit Evropian për Energji

Duke i përcjellë zhvillimet e reja në sektorin e energjisë respektivisht, procesin e integriteteve evropiane, KOSTT duhet të ndjekë rrugën e plotësimit të kërkesave dhe standardeve që rrjedhin nga këto procese. Plotësimi i standardeve gjithashtu është kërkesë e procesit të zhvillimit të projekteve voluminoze në KOSTT.

Bazuar në Planin Zhvillimor të Transmisionit (PZHT), KOSTT planifikon investimet për projektet kapitale sipas prioriteteve, respektivisht ndarjes në grupe të projekteve :

- 1. Projektet, që i ndihmojnë KOSTT-it në përf forcimin rrjetit transmetues;
- 2. Projektet, që përfshijnë riparimin e sistemit ekzistues të transmisionit;
- 3. Projektet, që përfshijnë monitorimin, kontrollin, matjet si dhe shërbimet ndihmëse me qëllim që KOSTT të kryej rolin si operator i sistemit transmetues dhe i tregut;
- 4. Projektet, me të cilat realizohet përkrahja e konsumit distributiv-nënstacionet e reja 110/x/kV.

Me që njëra nga objektivat strategjike të definuara në Planin e Biznesit të KOSTT është përkujdesja për shëndetin e punëtorëve të saj, për të plotësuar përgjegjshmërinë e saj nga aspekti social, KOSTT do të sigurojë se edhe më tutje do të kujdeset për shëndetin e punëtorëve dhe do t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit për punëtorët e saj. Për këtë qëllim, KOSTT ka realizuar projektin e sigurimit shëndetësor

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 64 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

suplementar, gjegjësisht sigurimin shëndetësor ndaras nga sigurimi shëndetësor shtetëror për të gjithë punëtorët me mjete buxhetore të kompanisë, i cili do të vazhdojë edhe në vitin 2016. Në vitin 2016 gjithashtu pritet të fillojë implementimi i Ligjit për sigurimin shëndetësor i cili do të ketë implikime buxhetore në kompani.

Sigurimi shëndetësor do të ndikojë në motivimin e punëtorëve për punë dhe me këtë, KOSTT do ta përmbush objektiven strategjike, për të qenë punëdhënës atraktiv. Mbrojtja dhe kujdesi për shëndetin e punëtorëve gjithashtu do të ndikojë edhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

Fokusi i KOSTT-it mbi menaxhimin e sigurisë dhe shëndetin në punë si dhe menaxhimin e mjedisit bazohet në:

- Politikën e sigurisë dhe mjedisit duke u angazhuar për të siguruar një vend punë të shëndetshëm dhe të sigurt si dhe të përgjegjshëm në menaxhimin e mjedisit për punonjësit tanë, kontraktuesit dhe komunitetin që mund të ndikohet nga aktivitetet tona të biznesit.
- Monitorimin dhe implementimin i kontrolleve sistematike mjekësore për të gjithë punëtorët konform kërkesave të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- Vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut në vendin e punës për punëtorët dhe pajisjet dhe përcaktimin e masave preventive paraprake për eliminimin apo parandalimin e tij;
- Zhvillimin i motivimit, informimit dhe trajnimeve të vazhdueshme duke bashkëpunuar me sektorët përkatës për përmirësim të vazhdueshëm të sigurisë në punë dhe kujdesit mjedisor;
- Inspektimin dhe monitorimin e vazhdueshëm në teren të objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes dhe procesin gjatë realizimit të projekteve, duke u fokusuar në përmbushjen e aplikimit të duhur dhe të plotë të procedurave si forma të verifikimit të brendshëm dhe masave preventive mbrojtëse;
- Përmbushjen e kërkesave që dalin nga standardet OHSAS 18001:2004 dhe ISO 14001:2007 dhe angazhimi për certifikim të integruar së bashku edhe me standardin ISO 901:2015;
- Mirëmbajtja dhe monitorimi i përgjithshëm i sistemit për mbrojtje nga zjarri dhe raste emergjente;

KOSTT edhe më tutje do të vazhdojë me punën e suksesshme për krijimin e një ambienti për investimin në zhvillimin profesional të punëtorëve dhe motivimin e tyre në arritjen e performancës së standardeve më të larta. Kjo është po ashtu në përputhje me objektiven strategjike - që të jetë punëdhënës atraktiv.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 65 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Me që KOSTT është i licencuar me standardin ISO 9001:2008, është duke e zhvilluar një proces të zhvillimit dhe menaxhimit të cilësisë sipas kërkesave të këtij standardi brenda të gjitha departamenteve dhe zyrave.

Në harmoni e me zhvillimet e reja të standardeve, respektivisht zhvillimit të standardit ISO 9001:2015, KOSTT ka planifikuar harmonizimin e kërkesave të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë të aplikuar në KOSTT me kërkesat e reja të standardit ISO 9001:2015.

Me qëllim të azhurnimit dhe harmonizimit të plotë të kërkesave gjatë vitit 2016, KOSTT ka planifikuar auditimin e brendshëm 2016 dhe auditimin e jashtëm – ricertifikimin në vitin 2016.

Gjatë vitit 2016 do të fillojë implementimi i plotë i kërkesave ISO 9001:2015 dhe do të ketë përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Në kuadër të Menaxhimit të cilësisë KOSTT, ka planifikuar zhvillimin e dy standardeve: Standardi për sigurinë e punëtorëve ISO 18001 dhe standardi për siguri të ambientit ISO 14001. Njëkohësisht, KOSTT është duke planifikuar integrimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe ndërtimin e një “sistemi të integruar të menaxhimit të cilësisë” duke krijuar mundësinë e plotësimit/integrimit edhe të standardeve për siguri të informacionit 27001 dhe 27002; IEC standardeve/standardeve për pajisje energjetike; standardin për menaxhimin e aseteve energjetike ISO 5500.

Dispozita e rëndësishme e normës Ndërkombëtare ISO 14001 përfshinë obligimin e ndërmarrjes në politikën personale të udhëheqjes me mjedisin, me të cilën ndërmarrja përcakton strategjinë dhe qëllimet e veta në raport ndaj mjedisit, duke realizuar synimet e veta në mënyrë që ato të jetësohen në praktikë. Me sistemin e udhëheqjes me mjedisin dhe sigurinë parashtrihen kritere të barabarta, brenda të cilave ka mundësi të planifikohen, zbatohen, verifikohen dhe të rishqyrtohen të gjitha ndikimet e mundshme në mjedis dhe masat e mbrojtjes së mjedisit në të gjitha segmentet e afarizmit në një ndërmarrje.

Parimet themelore të lidhura me udhëheqjen e mjedisit përfshijnë rinjohjen e aspekteve dhe ndikimeve në mjedis në bazë të cilave parashtrihen synimet dhe programet, përcillen rezultatet e matshme të zbatimit të tyre, andaj në mënyrë periodike ndërmerren aktivitete për përmirësim permanent.

Përmes procesit të certifikimit të sistemit të udhëheqjes me mjedisin dhe sigurinë, priten efekte pozitive, siç janë: përmirësimet e gjendjes në perimetrin mjedisor dhe të sigurisë vetanake, investimet më racionale në projektet e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë, si dhe shumë efekte tjera të ngjashme. Nga ana tjetër, synohet një avancim në raport me institucionet kompetente, duke bërë ngritjen e përgjegjësisë dhe vetëdijes mbi mbrojtjen e mjedisit dhe të sigurisë në tërësi, si dhe duke përmirësuar pasqyrën afariste ndaj publikut të gjerë, gjë që i kontribuon përmbushjes së synimeve themelore afariste të KOSTT-it.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 66 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Me këtë qasje KOSTT-i si ndërmarrje publike bëhet anëtar i përhershëm, i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm i mjedisit në të cilin vepron si dhe përmes sistemit që aplikon, me qëllim që ta përparojë cilësinë e jetës në mjedisin e drejtpërdrejtë, si dhe atë në nivelin global.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 67 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2. 7. Rreziqet

Në afarizmin e KOSTT, kanë ndikim edhe rreziqet e mundshme, si pasojë e ndikimeve që vijnë nga jashtë, respektivisht nga rrethina afariste, dhe si të tilla, kanë implikimet e tyre në veprimtarinë e KOSTT.

Në vazhdim janë analizuar dhe identifikuar disa nga këto rreziqe:

- Pamundësia e fillimit të operimit të KOSTT-it si zonë/bllok rregullues i njohur nga ENTSO-E për shkak të obstrukcioneve nga Serbia. Për pasojë, nuk menaxhohen kongestionet në linjat interkonektive dhe alokimi i kapaciteteve nga KOSTT, dhe kështu vazhdon bllokimi i KOSTT-it në integrim, respektivisht në zhvillim dhe hapje të tregut
- Pamundësia e fillimit të operimit të KOSTT si zonë rregulluese do të pengoj Kosovën në përmbushjen e zotimeve të 6 shteteve të Ballkanit, e njohur si iniciativa e WB6 për themelimin e tregut të organizuar (spot market), tregut rajonal balancues dhe alokimit rajonal të kapaciteteve interkonektive.
- vështirësitë e mundshme financiare nga mos inkasimi i të hyrave;
- risku rregullator në miratimin e tarifave që nuk reflektojnë koston reale;
- eficienta prej 4% e kërkuar nga ZRRrE, që për KOSTT është e pamundur të arrihet
- gjendja e aseteve të transferuara nga KEK-u gjithashtu paraqesin kërcënim në zvogëlimin e performancës së furnizimit
- kriza globale;
- pamundësia e operimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të një pjese të rrjetit transmetues të Kosovës, për shkak të qasjes së kufizuar në pjesën veriore të vendit, si dhe ndërhyrjes ilegale të Operatorëve serb EMS dhe EPS.
- Gjendja e aseteve të transferuara nga KEK-u

Në mënyrë që të ulët ndikimi në secilin rrezik, janë të domosdoshme këto veprime:

- Vazhdimi i aktiviteteve rreth evitimit të pengesave nga EMS dhe anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur në ENTSO-E;
- Avancimi i operimit i sistemit të transmissioinit që i paraprinë me aftësinë e sistemit elektroenergjetik të akomodojë kërkesat e shfrytëzuesve të sistemit duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, posaçërisht ndaj investitorëve privat të gjenerimit dhe furnizimit dhe shpërndarjes;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit duke sqaruar avantazhet e tregut të energjisë elektrike;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 68 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

- Analiza e mundësisë që KOSTT dhe Kosova të jenë pjesë e APE (Albanian Power Exchange), që është duke u zhvilluar në Shqipëri në kuadër të iniciativës WB6.
- Implementimi eficient i investimeve kapitale të KOSTT-it

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>ver. 1.1</i>		<i>faqe 69 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Aneks

1. Sponzorimet dhe donacionet

Gjatë vitit 2015 KOSTT ka ndarë 12,000.00 € në emër të bursave për studentët e Universitetit të Prishtinës dhe në emër të shpenzimeve për studentë që kanë mbajtur praktikën në Kostt janë ndarë 1,397.70 €.

Po ashtu, në kuadër të përgjegjësisë shoqërore korporative, KOSTT ka dhënë përkrahje financiare për:

- Shoqatën Down Sindrom Kosova 200 Euro
- Monografinë për zhvillimin e rrjetit të energjisë elektrike 2,500 Euro.

Në tërësi janë ndarë **16,097.70 Euro**.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 70 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2. Raporti i auditorit të brendshëm

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Aktiviteti auditues është ushtruar sipas parimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, procedurave dhe standardeve të cilat janë në funksion të auditimit të brendshëm.

Për vitin 2015 është përgatitur plani i auditimit të brendshëm dhe është prezantuar para Komisionit të Auditimit, i cili është aprovuar në përputhshmëri të plotë me standardet e auditimit.

Objektivat, aktivitetet dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm gjatë vitit 2015 janë zhvilluar në bazë të planit strategjik dhe vjetor të auditimit.

“Çdo aktivitet në kuadër të Ndërmarrjes Publike kërkohet të siguroj që veprimet, të dhënat në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit t’i nënshtrohen rregullisht dhe në mënyrë sistematike procedurave të brendshme audituese. “

Pjesë e rëndësishme e procesit për menaxhimin e një funksioni të auditimit është planifikimi i aplikuar sipas këtyre metodave:

- **Objekti i auditimit** – duhet të disponojë dëshmi të mjaftueshme dhe adekuate për të shprehur konkluzione dhe rekomandime efikase.
- **Metodologjia e auditimit** – Përcaktimi i proceseve dhe procedurave që duhet të auditohen.
- **Vlerësimi i rrezikshmërisë** – matet nga devijimet (shmangiet) e ligjeve dhe procedurave.
- **Përcaktimi i prioriteteve audituese** – në bazë të:
 - Ndikimit financiar dhe material;
 - Rasteve urgjente me rrezikshmëri të lartë;
 - Ndërlíkueshmëria në proceset audituese;
 - Kohëzgjatja e fushës së auditimit;
 - Rëndësia për imazhin afarist të kompanisë dhe
 - Faktorët e brendshëm të cilët kërkojnë ekzaminim për çështjet e caktuara.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave audituese, në vazhdim janë dhënë disa prej aktiviteteve kryesore të aplikuara gjatë fushëveprimit auditues:

- Testime për mënyrën e funksionimit të kontrollit të brendshëm;
- Testime për nivelin e zbatueshmërisë së planeve mujore dhe vjetore të transaksioneve me ndikim material;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 71 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

- Testime për nivelin e zbatueshmërisë së ligjeve, politikave, procedurave dhe rregullave përkatëse;
- Përzgjedhjen e transaksioneve, sipas mostrimit statistikorë, me shtresim dhe gjykimin profesional;
- Testime substanciale gjithëpërfshirëse për transaksionet financiare;
- Vlerësimin e performancës së afarizmit të kompanisë;
- Vlerësimin e performancës së menaxhimit të planit të biznesit;
- Vlerësimin e performancës për realizimin e planit buxhetor;
- Niveli i veprimeve korigjuese të marra nga Menaxhmenti;
- Aplikimi i një kombinim procedurash si: intervista, rishikime analitike, rishikim dokumentacioni;
- Ekzaminime fizike të menaxhimit të pasurisë;
- Testime të dokumentacionit, për mënyrën e menaxhimit të projekteve;
- Testime të dokumentacionit për mënyrën e aplikimit të procedurave të prokurimit;
- Testime të dokumentacionit për nivelin e përmbushjes së implementimit të rekomandimeve, etj.

Gjatë vitit 2015 janë audituar pesë departamente me sektorët përkatës dhe një auditim i jashtëzakonshëm jashtë planit të auditimit.

Janë përgatitur pesë raporte të auditimit sipas planit të auditimit dhe një raport sipas kërkesës së jashtëzakonshme nga Menaxhmenti Ekzekutiv.

Raportet janë dorëzuar te Komisioni i Auditimit dhe pala audituese, sipas rregullave dhe procedurave për auditim të brendshëm. Në raportet e auditimit të brendshëm janë prezantuar aktivitetet, objektivat, të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.

KONSTATIMI PËR RAPORTET E AUDITIMIT

Gjatë vitit 2015 auditimi është kryer në bazë të plan programeve, objektivave dhe aktiviteteve të parapara. Departamentet e auditori, janë përzgjedhur në bazë të nivelit të përgjegjësisë, kompleksitetit, riskut, natyrës së vëllimit të aktiviteteve, për të cilat Menaxhmenti Ekzekutiv duhet të veprojë në mbështetje të plotë për implementimin apo zvogëlimin e rekomandimeve.

Gjatë auditimit janë testuar dhe ekzaminuar çështjet me ndikim më të lartë, ku në vazhdimësi të procesit të auditimit janë dhënë rekomandimet të cilat janë prezantuar në raportet e auditimit. Janë dhënë edhe këshilla gojore të ndryshme varësisht nga natyra dhe kërkesa e personelit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 72 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Departamentet e audituara dhe shkalla e implementimit të rekomandimeve

Nr.	Departamentet- Sektorët	Rekomandimet për vitin 2015	Implementimi i rekomandimeve të vitit 2014
1.	Departamenti i Transmisionit	18	12 nga 18
2.	Departamenti i Operimit të Sistemit	5	Nuk ka pasur
3.	Departamenti i Burimeve Njerëzore	16	4 nga 8
4.	Departamenti i Financave	6	7 nga 10
5.	Departamenti i Prokurimit	13	5 nga 9
6.	Auditim jashtë planifikimit, për shpronësimet, servitutet dhe dëmet, për linjën 1806	3	Nuk ka pasur

Raportet paraqesin nivel kyç për adresimin e këshillave në ngritjen e nivelit të përmirësimit për dobësitë, gabimet apo paqartësitë të cilat ekzistojnë në ndërmarrje. Në përgjithësi auditimi ka reflektuar pozitivisht në ngritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të ndërmarrjes.

Në përgjithësi subjektet e audituara kanë treguar progres në përmirësimin e sistemit të mjedisit të kontrollit, zbatimin e procedurave, ligjeve dhe rregullave përkatëse, gjithashtu kanë treguar një bashkëpunim të mirë duke marrë për bazë këshillat dhe rekomandimet të cilat do të jenë gjithmonë në funksion të zhvillimit të Ndërmarrjes.

Raportimi i të gjeturave tona në kohë dhe cilësi është një mbështetje për ndërmarrjen që të sigurojë llogaridhënie në cilësinë e menaxhimit dhe funksionimit të saj.

Gjatë vitit auditues 2015 subjektet audituese i kanë përgatitur planet për veprim për implementim të rekomandimeve dhe kemi aplikuar testime matëse për shkallën e zbatueshmërisë së implementimit të tyre, të cilat janë të prezantuara në tabelën nr. 2.

KONSTATIM PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE

Vlerësimi i implementimit të rekomandimeve

Nr.	Departamentet	Plani për implementim	Implementim i tërësishëm	Implementim në Proces
1.	Departamenti i Transmisionit	I Përgatitur	70 %	30 %
2.	Departamenti i Operimit të Sistemit	I përgatitur	Nuk ka pasur	Nuk ka pasur
3.	Departamenti i Burimeve Njerëzore	I përgatitur	50 %	50 %

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 73 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

4.	Departamenti i Financave	I përgatitur	70 %	30 %
5.	Departamenti i Prokurimit	I përgatitur	60 %	40 %
6.	Auditim jashtë planifikimit, shpronësimet, servitutet dhe dëmet, për linjën 1806	Nuk është përgatitur	Nuk ka pasur	Nuk ka pasur

Të gjitha rekomandimet e prezantuara i përkasin natyrës për forcimin e kontrollit të brendshëm, nivelin e përgjegjësisë, eliminimin e gabimeve apo paqartësive në funksion të përmirësimit të sistemit. Në bazë të kësaj, konstatojmë se ka avancime pozitive në implementimin e rekomandimeve të cilat janë në interes të Ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2015 janë dhënë rekomandime konstruktive në përmirësim të dobësive dhe kjo ka dhënë rezultate pozitive në funksion të optimizimit të vlerës së Ndërmarrjes. Nga afër përcillet mënyra se si adresohen dhe implementohen rekomandimet dhe vazhdohet puna në partneritet të ngushtë me stafin përgjegjës të nivelit ekzekutiv.

Si deri më tani, edhe më tutje, do të punohet në mënyrë të vazhdueshme, duke prezantuar këshillat më të dobishme në funksion të avancimit të performancës në Ndërmarrje.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 74 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

3. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike

3.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2015

Struktura organizative aktuale është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it në korrik 2013 dhe përbëhet nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti.

Për të performuar me punët e reja që ndërlidhen me operimin e KOSTT si zonë/bllok rregullues dhe implementimin e marrëveshjeve operative me ENTSO-E dhe OST-të fqinje, në veçanti me obligimet që Operimi i Tregut duhet ti kryejë në bazë të Rregullave të Tregut si: procesi i Skedulimit, Accountingut, agjentit për administrimin e matjeve, etj. është paraqitur nevoja e ristrukturimit të këtij departamenti, i cili është miratuar në vitin 2015.

Struktura e menaxhmentit më të lartë të KOSTT-it përbëhet nga pozitat vijuese: Kryeshefi Ekzekutiv (KSHE), Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv; Sekretari i Kompanisë; Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, e Auditori i Brendshëm dhe drejtorët e departamenteve vijuese:

- Operatori i Sistemit;
- Operatori i Transmisionit;
- Operatori i Tregut;
- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve;
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative;
- Financat;
- Burimet Njerëzore;
- Prokurimi;
- Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, që mbulon Zyrën për Zhvillimin dhe Planifikimin Afatgjatë, Zyrën për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun dhe Zyrën për Sigurinë Industriale dhe Mjedisin.

Numri i Punëtorëve

Me datën 1 Janar 2015 numri i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT ka qenë 358, ndërsa me datën 31 Mars 2015 numri i të punësuarve është 356.

Gjatë periudhës tremujore Janar – Mars 2015 ka pasur lëvizje të punëtorëve për këto arsye:

4 (katër) punëtorë janë pensionuar sipas fuqisë ligjore gjatë muajit Mars 2015

2 (dy) punëtorë të rinj janë rekrutuar gjatë muajit Shkurt 2015

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 75 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	


Gjatë tremujorit të dytë, ka pasur lëvizje të punëtorëve. Me datën 1 Prill 2015, numri i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT ka qenë 356, ndërsa me datën 30 Qershor 2015 numri i të punësuarve është 355, sepse 1 (një) punëtor është pensionuar sipas fuqisë ligjore.

Gjatë periudhës Korrik - Shtator 2015, ka pasur lëvizje të punëtorëve për shkak se (tre) punëtorë janë pensionuar sipas fuqisë ligjore.

Kështu, në fund të tremujorit të tretë (30 shtator), numri i punëtorëve ka rënë në 352.

Me datën 1 Tetor 2015, numri i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT ka qenë 352, ndërsa me datën 31 Dhjetor 2015 numri i të punësuarve është 349, sepse 4 (katër) punëtorë janë pensionuar sipas fuqisë ligjore, ndërsa 1 (një) punëtorë është punësuar.

Në vazhdim është dhënë Organo gram – Makro Struktura organizative e KOSTT-it.



	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 77 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

3.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore

Nr.R	Lënda Gjykata Nr. Themelore Kompetente	Paditës	I paditur	Objekti Kontestit	Vlera e Kontestit
1	P.nr.326/0 Gjykata Kaçanik Themelore	KOSTT	Nebih Bela, Veli Bela dhe Minir Mani	Vjedhje	2,370.00 €
2	P.nr. 2406/ 06 Gjykata Prishtinë Themelore	KOSTT	Ivica Filipoviq dhe Millorad Iliq	Vjedhje	15,398.00 €
3	P.nr. 284/06 Gjykata Prishtinë Themelore	KOSTT	Avdullah Bejtullahu dhe Afrim Bejtullahu	Vjedhje e rëndë	Nuk është përcaktuar
4	C.nr. 409/06 Gjykata Prishtinë Themelore	Hajrije dhe Milazim Zeka	KOSTT	Lirimi banesës i	Nuk është përcaktuar
5	C.nr.511/00 C.nr.2888/09 Gjykata Prishtinë Themelore	KOSTT	Fadil Hashani, Halil Selmanaj, Besnik Zhitia, Valdet Vatovci etj	Lirimi lokaleve në Kurriz i	Nuk është përcaktuar
6	C.nr. 2168/04 Gjykata Prishtinë Themelore	KOSTT	Kadri Rukovci	Lirimi banesës i	Nuk është përcaktuar
7	C.nr. 156/09 Gjykata Prishtinë Themelore	KOSTT	Qamil Kabashi	Kompensim Dëmi	11,020.00 €
8	C.nr.571/11 C.nr.351/15 Gjykata Skenderaj Themelore	Shaqir Duli	KOSTT	Kompensim Dëmi	10,000.00 €
9	C.nr. 156/09 Gjykata Prishtinë Themelore	Selvije Dedinca etj	KOSTT	Pagesa rentës e	600 € Pagesë Mujore

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 78 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

10	C.nr. 270/07 C.nr.202/14 Gjykata Themelore Podujevë	Mustafë Hasani etj	KOSTT	Kompensim Dëmi	1,242.910.00 €
11	C.nr.218/11 Gjykata Themelore Ferizaj	Fevzi Nebihu	KOSTT	Pengesë Posedimi	1,600.00 €
12	C.nr.2255/06 Gjykata Themelore Prishtinë	Xhemile Berisha	KOSTT	Kompensim dëmi në formë të ushqimit	400 € vlerë mujore
13	E.nr.281/06 Gjykata Themelore Lipjan	KOSTT	Momqillo Mitiq	Kompensim dëmi	2,176.50 €
14	C.nr.244/2013 Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	KEK	Kompensim dëmi	140,285.56
15	C.nr.438/10 Gjykata Themelore Ferizaj	Kenan Mehmeti	KOSTT	Pagesa e rentës	29,764.49
16	Nd.nr. 42/09 Gjykata Themelore Ferizaj	Agron Vuçitërna	KOSTT/ KEK	Kompensim dëmi	Nuk është përcaktuar
17	C.nr.116/13 Gjykata Themelore Gjiilan	Xhevat Qerimi	KOSTT/ KEK	Të drejtën e blerjes banesore	Nuk është përcaktuar
18	C.nr.58/14 Gjykata Themelore Pejë	Hetema Cikotiq	KOSTT	Të drejtën e blerjes banesore	Nuk është përcaktuar
19	C.nr.127/14 Gjykata Themelore Pejë	Hamdija Cikotiq	KOSTT	Të drejtën e blerjes banesore	Nuk është përcaktuar
20	A.nr. Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	OSHP	Propozim për masën e përkohshme	Nuk është përcaktuar
21	C.nr.106/14 Gjykata Themelore Vushtrri	Bejtullah Isufi dhe Nazif Isufi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
22	C.nr.142/14 Gjykata Themelore Vushtrri	Aziz Klinaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar



RAPORT VJETOR

DT-FI-008

ver. 1.1

faqe 79 nga 87

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

23	C.nr.172/14 Gjykata Themelore Lipjan	Sali Shala dhe Avdullah Shanhini	KOSTT	Kompensim dëmi	4,000.00 €
24	C.nr.327/14 Gjykata Themelore Prishtinë	Selvije Dedinca etj	KOSTT	Kompensim i Kamatës	Nuk është përcaktuar
25	C.nr.45/14 Gjykata Themelore Drenas	Bajram Hisen Hajradini	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	5,748.00
26	C.nr.48/14 Gjykata Themelore Drenas	Gani dhe Afrim Morina	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
27	C.nr.139/04 Gjykata Themelore Podujevë	Nebi Sadiku etj	KOSTT/KEK	Kompensim dëmi LP400kV	732,000.00 €
28	C.nr.39/14 Gjykata Themelore Drenas	Ferat Morina	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	3,077.60
29	C.nr.50/14 – 52/14 Gjykata Themelore Drenas	Bes Company	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	67,843.50 €
30	C.nr.32/14 Gjykata Themelore Drenas	Ahmet Fazlija	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
31	C.nr. 47/14 – 3/15 Gjykata Themelore Drenas	Shaqir Podrimqaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	3,000,000.00 €
32	C.nr.49/14 – 51/14 Gjykata Themelore Drenas	Shaqir Nysret Binaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	33,020.00 €
33	C.nr.1/15 Gjykata Themelore Drenas	Ismet Binaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
34	C.nr.42/15 Gjykata Themelore Drenas	Ejup Hoxha	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	1,073
35	C.nr.5/15 Gjykata Themelore Drenas	Dibran Hoxha	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	4,203
36	C.nr.43/14 Gjykata Themelore Drenas	Hetem Binaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	75,849.80 €
37	C.nr.6/15 Gjykata Themelore Drenas	Sabit Morina	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	13,478.50 €
38	C.nr.44/14 Gjykata Themelore Drenas	Feriz Bytyqi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	1,075.00 €
39	C.nr.29/15 Gjykata Themelore Drenas	Albert Nika	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	4,835.30 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 80 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

40	C.nr.46/15 Gjykata Themelore Drenas	Lulzim Makolli	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	2,842.25 €
41	C.nr.27/15 Gjykata Themelore Drenas	Asmon Binaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	39,370.00 €
42	C.nr.34/15 Gjykata Themelore Drenas	Jakup Krasniqi etj	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	6,663.00 €
43	C.nr.33/15 Gjykata Themelore Drenas	Agim Hoxha	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	8,079.25 €
44	C.nr.40/15 Gjykata Themelore Drenas	Nazif Krasniqi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
45	C.nr.39/15 Gjykata Themelore Drenas	Qamil Hoxha	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
46	C.nr.41/15 Gjykata Themelore Drenas	Shukrije Bytyqi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
47	C.nr.46/15 Gjykata Themelore Drenas	Rifat Krasniqi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
48	C.nr.44/15 Gjykata Themelore Drenas	Bajrush Karaqica	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
49	C.nr. Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	Second Hand	Lirim Lokali	3,100.00 €
50	C.nr.791/15 Gjykata Themelore Prishtinë	Nazmi Shaljani	KOSTT	Dislokim Shtylle ose sig. parc e re	Nuk është përcaktuar
51	C.nr.1642/19 Gjykata Themelore Prishtinë	Ilmi Jakupi	KOSTT	Dëmshpërbli m	Nuk është përcaktuar
52	C.nr.987/14 Gjykata Themelore Pejë	Hamdi Sadrijaja	KOSTT/KEDS	Dëmshpërbli m	20,000.00 €
53	A.nr.428/12 Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	ZRrE	Anulim Vendimi	3,882,812.00 €

Totali i vlerës KOSTT si i paditur: **5,308,432.69 €**

Totali i vlerës KOSTT si i paditës: **4,057,162.06 €**

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>fajqe 81 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

3.3. Kontratat/Transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit 2015 nga burimet e KOSTT

Nr	Departamenti	Lloji i Prokurimit	Nr i Procedurës	Emri i Projektit	KONTRAKTORËT	Vlera e Kontratës	Vlera e Realizuar e Kontratës	Vlera e mbetur për realizim	Përqindja e Realizimit	Nr. i Protokollit
1	Departamenti i Operatorit të Sistemit	Procedurë e Hapur	085/13	Upgrade and update of existing RTU product	konz:Koncar & G3 Inxhiniering	1,683,129.84 €	544,192.58 €	1,138,937.26 €	32.33%	nr.106 dt.20.03.2015
2	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Procedurë e Hapur	020/14	Instalimi i TR2 ne NS 110/10 kV - Berivojce dhe NS Viti	konz:Monting&Electra	689,323.62 €	497,684.35 €	191,639.27 €	72.20%	nr.70 dt.03.03.2015
3	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Procedurë e Hapur	31	Sigurimi shëndetësor i punëtorëve	Kosova e RE KS	380,000.00 €	24,568.74 €	355,431.26 €	6.47%	nr.286 dt.20.08.2015
4	Departamenti i Operatorit të Tregut	Procedurë e Negociuar Pa Publikim të Njoftimit të Kontratës	49	Rifreskimi dhe Mirëmbajtja e IT se tregut	SIEMENS AG	338,314.26 €	0.00 €	338,314.26 €	0.00%	nr.315 dt.22.09.2015
5	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Procedurë e Hapur	20	Furnizim me Karburante për dhe Automjete dhe Gjeneratorë	IP-KOS shpk	300,000.00 €	47,700.35 €	252,299.65 €	15.90%	nr.183 dt.26.05.2015

**RAPORT VJETOR****DT-FI-008***ver. 1.1**fajqe 82 nga 87**Departamenti Financiar**Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:*

6	Departamenti i Operatorit të Sistemit	Procedurë e Negociuar Pa Publikim të Njoftimit të Kontratës	092/14	Realizimi observimit të ndërsjellë të rrjetit transmetues	ALSTOM GRID SAS	166,666.67 €	74,442.14 €	92,224.53 €	44.67%	nr.66 dt.25.02.2015
7	Departamenti për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhinieri	Procedurë e Negociuar Pa Publikim të Njoftimit të Kontratës	55	Punët shitesë: Instalimi i TR2 në NS 110/10(20) - Skenderaj	UKAB	141,024.85 €	0.00 €	141,024.85 €	0.00%	nr.328 dt.08.10.2015
8	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Procedurë e Negociuar Pa Publikim të Njoftimit të Kontratës	9	Mirëmbajtja e CAS-it	KOMTEL PE	80,000.00 €	8,920.37 €	71,079.63 €	11.15%	nr.263 dt.03.08.2015
9	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Procedurë e Hapur	61	Mirëmbajtja e Harduerit të TI	Clastertech	70,000.00 €	0.00 €	70,000.00 €	0.00%	nr.327 dt.06.10.2015
10	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Procedurë e Hapur	22	Pastrimi i traseve të linjave 400/200/110kV nga drunjtë	EUROTONI	60,000.00 €	11,942.00 €	48,058.00 €	19.90%	nr.228 dt.24.06.2015

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 83 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

TOTALI:	3,908,459.24 €	1,209,450.53 €	2,699,008.71 €	30.94 %
----------------	----------------	----------------	----------------	---------

Përqindja e realizimit në vlerën 30.94 % , paraqet përqindjen vetëm për dhjetë projektet më të mëdha sipas LPP gjatë vitit 2015.

Informatat tjera rreth kontratave në vitin fiskal 2015 , është:

Vlera e kontratave :	5,195,633.86 €
Realizimi :	1,866,192.64 €
Vlera e mbetur për realizim :	3,329,441.22 €
Përqindja e Realizimit	35.92 %

Kontrata mbi 1,000 euro, janë gjithsejtë 94 procedura, ku përfshihen:

- Kontrata me vlera të vogla : **48 procedura**
- Kontrata në vlera të mesme : **39 procedura**
- Kontrata me vlera të mëdha : **7 procedura**

Në mesin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2015 janë realizuar edhe 11 procedura të negociuara.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 84 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

3.4. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës

Në mënyrë që KOSTT të rritë edhe më tutje performancën, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- Vazhdimin të ngritjes së efijencës në mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmisionit
- Implementimit të projekteve kryesore që risin kapacitetet e operimit në interkonjeksion me Shqipërinë, e që lidhen me operimin e mëvetësishëm të KOSTT dhe arritjen e efijencës të të hyrave nga investimet;
- Përmirësimet në asetet e transferuara nga KEK-u dhe futja e teknologjisë për monitorim, kontroll, matje dhe operim, pajisja e të gjitha objekteve (NS-ve)
- Përgatitjet për implementimin e plotë të Rregullave të Tregut
- Vazhdimi i trajnimit të stafit dhe formave tjera të zhvillimit për përcjellje të ndryshimeve teknologjike që ritë shkathtësitë dhe njohurit për ngritjen e efijencës në KOSTT;
- Vazhdimi i shqyrtimit të masave motivuese për stafin për ngritjen e kualitetit të punës së tyre.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 85 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Lista e shkurtesave

AATC - (Average Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar (Import/Eksport)

AIT – (Average interruption time) - koha mesatare e rënieve

ATC – (Available Transfer Capacity) – Kapaciteti i disponueshëm

BCU- (Bay Controll Unit)- njësia kontrolluese

BD – Bordi i Drejtorëve

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

CGES- (crnogorski Elektro Sistem) – OST i Malit të Zi

DMS-(Documents Management System) – Sistemi për menaxhimin e dokumentacionit

EJL – Evropa Juglindore

EMS- (Elektro Mreza Srbije) - Rrjeti Elektrik i Serbisë

ENS- (Energy not supplied)-Energjia e pa furnizuar

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

FAC- (Final Acceptance Certificate) – Çertifikata e pranimit final

GSM –(Global System for Mobile Communication) – sistemi i përgjithshëm i komunikimit mobil

GJK – Gjykata Komunale

GjQ – Gjykata e Qarkut

HC - Hidrocentral

HMI – (Human Machine Interface) – ndërlidhja makinë-njeri

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 86 nga 87</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

HVM- (High Voltage Metering) – matësi i energjisë

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

IPA- Instrumentet para anmtarësimit në Bashkimin Evropian

ITC – Inter TSO Compensation (Kompensimi mes Operatorëve të Sistemit të Transmisionit)

KA – Konflikt Administrativ

KE – Kryeshefi Ekzekutiv

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KESCO - (Kosovo Electricity Supply Company)- Kompania e Kosovës për Furnizim me Energji Elektrike

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KIEK – Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

KQKO - Komiteti për Qeversje të Kodeve Teknike/Operacionale

LP – Largpërçuesi

LPP – Ligji i Prokurimit Publik

MATC - Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal (Import/Eksport)

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planit Hapsionor

MPI – Menaxhimi i Projekteve dhe Inxhinieria

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NEF (Net Export Flow) – Eksporti i Kosovës

NIF - (Net Import Flow) – Importi neto për nevojat e Kosovës

NMS – (Network Management System) – Sistemi për menaxhimin e rrjetit

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>ver. 1.1</i>		<i>faqe 87 nga 87</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

OPGW – fibri optik

OS – Operatori i Sistemit

OST – Operator i Sistemit të Transmisionit

OT – Operatori i Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

PZhT – Plani Zhvillimor i Transmisionit

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Managment System)
-Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

SSE – Sistemi Elektro Energjetik

TC A – Termocentrali Kosova A

TC B – Termocentrali Kosova B

TCP/IP – (Transport Communication Protocol) –Internet protokole të komunikimit

TE- (Transmited energy)- Energjia e transmetuar

TI – Teknologjia e informacionit

TMR – Transformatori matës i rrymës

TL – Tensioni i lartë

ToR (Terms of Reference) – Termat e Referencave

TTC – (Total Transfer Capacity) – kapaciteti total i bartjes

USAID - (Unated States Agenci for International Development) – Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar)

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë